

UNIVERSITETI I EJL
ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY



FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT
ФАКУЛТЕТ ЗА ЈАЗИЦИ, КУЛТУРИ И КОМУНИКАЦИЈА
FACULTY OF LANGUAGES, CULTURES AND COMMUNICATIO

STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA E ARSIMIT

TEZA:

**MENAXHIMI, NDRYSHIMET DHE KUSHTET
E PUNËS NË SHKOLLAT FILLORE TË PRIZRENIT**

Kandidatja:
Valbona Duraku

Mentori:
Prof. dr. Hasan Jashari

Tetovë 2019

PËRMBAJTJA -

ABSTRAKT	
HYRJA	
QËLLIMET E HULUMTIMIT	

KAPITULLI I

1. ASPEKTI TEORIK (PJESA I)

1.1. MENAXHIMI I SHKOLLAVE DHE NDRYSHIMET NË KOSOVË DHE PRIZREN

1.2. Menaxhimi i ndryshimeve në shkollë

1.3. Menaxhimi i shkollës

1.4. Kuptimi i konceptit menaxhim.

1.5. Kuptimi i konceptit ndryshim.

1.6. Shkolla si institucion ku ndodhin ndryshimet

1.7. Arsimit faktor i ndryshimit.....

2. MENAXHIME ME NDRYSHIME NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË .

2.1. Arsimit Parauniversitar në Kosovë

2.2. Standardet e drejtuesit të shkollës menaxhim.....

2.3. Cilësia dhe efektiviteti

2.4. Kapacitetet menaxhuese të sistemit.....

2.5. Parimi i efikasitetit dhe i efektivitetit.....

3. REFORMAT ARSIMORE NË KOSOVË.....

3.1. Dinamika e reformave arsimore në Kosovë.....

3.2. Arsimit në këndvështrimin e reformave.....

3.3. Ndikimi i shoqërisë.....

3.4. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore.....

4. REFORMAT ARSIMORE NË PRIZREN.....

- 4.1. Procesi i përgatitjeve.....
- 4.2. Vizioni dhe misioni.....
- 4.3. Objektivat strategjike.....

5. KUSHTET E PUNËS DHE SHKOLLA.....

- 5.1. Përvojat e nxënësve nga mësimi.....
- 5.2. Procesi procesi mësimor, shkolla dhe puna.....
- 5.3. Infrastruktura dhe hapësira e shkollës.....
- 5.4. Puna financiare e shkollës.....
- 5.5. Materiale dhe mjete mësimore.....

6. KUSHTET E PUNËS DHE SUKSESI.....

- 6.1. Arritjet e nxënësve.....
- 6.2. Rezultatet e nxënësve.....
- 6.3. Menaxhimi dhe organizimi i kushteve dhe suksesit.....
- 6.4. Motivimi i nxënësve.....

PERCEPTIMI I NDRYSHIMEVE NGA PRINDËRIT DHE ME NXËNËSIT, BASHKËSINË LOKALE DHE AFARSITËT

- 7.1. Nxënësit, mësuesit, prindërit dhe shoqëria.....
- 7.2. Refleksionet-opinione të mësuesve, nxënësve dhe prindërve.....

KAPITULLI II

ASPEKTI EMPIRIK (PJESA II)

1. METODOLOGJIA E PUNËS HULUMTUESE

- 1.1. Lënda e kërkimit (Objekt studimi).....
- 1.2. Qëllimet e kërkimit.....
- 1.3. Metodologjia e kërkimit.....
- 1.4. Qëllimet dhe detyrat e hulumtimit.....
- 1.5. Hipotezat.....
- 1.6. Variablat e studimit.....
- 1.7. Instrumentet e kërkimit.....
- 1.8. Metodatat e kërkimit.....
- 1.9. Rëndësia e kërkimit.....
- 1.10. Parapërgatitja dhe organizimi.....

1.11. Metodatat e kërkimit..... .. .

2. Case Study Studim rasti i shkollave fillore..... .. .

2.1. Metodologjia e hulumtimit.

2.3. Organizimi i hulumtimit... .. .

ABSTRAKT

Kjo temë magjistrature trajton menaxhimin, ndryshimet dhe kushtet e punës në shkollat fillore të Prizrenit.

Modeli që praktikohet në këtë studim i përshtatet strategjisë kërkimore, të metodave dhe teknikave të cilat në lëmin e arsimit janë të aplikueshme.

Menaxhimi me procesin edukativ - arsimor me institucionet shkollore në komunën e Prizrenit paraqet një sfidë tepër të madhe edhe për menaxherët, arsimtarët, nxënësit, por edhe për shoqërinë në tërësi. Komuna e Prizreni përfshin 48 shkolla fillore në vitin shkollor 2009-2010 dhe ka pasur 29943 nxënës. Në shkollat e mesme të ulëta në të njëtin vit shkollor ka pasur 8779 nxënës në tri shkolla të mesme.

Vetë madhësia e shkollave, numri i madh i nxënësve dhe hapësira e pamjaftueshme e ndërlikojnë procesin dhe e vështirësojnë menaxhimin me procesin edukativ - arsimor.

Qasja që praktikohet në këtë studim demonstroi shembull të natyrës analitike shkencore me parashikime se rregullat e globalizimit të shoqërisë janë në rrjedhë që t'i imponohen edhe vendit tonë. Kemi bërë përpjekje maksimale që ky studim të iniciojë vënie të udhëheqjes së shkollave në themele akademike, që do t'ju shërbejë gjeneratave si preventivë në ngritjen e një shoqërie të ardhme.

Do të praktikohen instrumente, teknika, strategji dhe metoda analitike nga hulumtime të natyrës deskriptive, joeksperimentale që praktikisht praktikohen në vendet me përvojë shkencore të zhvilluara.

Studimi konstaton se do të fokusohet në rolin e drejtorit të shkollës se sa është ai modern dhe sa ka mundur të ofrojë kushte të punës në shkollë për të mbijetuar në konkurrencë të mjedisit modern, në një ekonomi të tregut të punës ku vazhdimisht është i pranishëm dinamika e konkurrencës.

Motivi për t'iu qasur këtij problemi është gjendja e udhëheqjes aktuale në shkollë.

Fjalet kyçe: krijimi i klimës pozitive, stilet e punës, qëllimi i vizionit.

HYRJE

Kjo temë magjistrature do të shkoqitë çështjet të cilat kanë të bëjnë me kushtet e punës dhe menaxhimin e shkollave bashkëkohore në komunën e Prizrenit.

Punimi është i nevojshëm për shkencën dhe shoqërinë, ndoshta për shkak të nevojës për udhëheqje efektive dhe efikase.

Kushtet e punës dhe menaxhimi i shkollave bëhet përmes udhëheqësit të shkolluar, të specializuar, të profesionalizuar për institucionalizimin e ndryshimeve të nevojshme në shkollë.

Në këtë kohë kur në vendet evropiane mbretëron tregu i ekonomise së dijeve dhe aftësive teknologjike, në vendin tonë kultura e mjedisit të shkollave është akoma tradicionale dhe kushtet e punës janë shumë të vështira.

Andaj dhe unë mora qëndrim, vullnet dhe dëshirë që të hulumtoj se sa kanë përparuar këto dhjetë vitet e fundit shkollat fillore në Kosovë e veçmas në Prizren. Çështje të cilat ngjallin debate edhe te prindërit edhe tek arsimtaret, politikanët kanë të bëjnë kryesisht me pyetjen se si shkon procedura e zhvillimit të procesit arsimor dhe cilat janë kushtet e punës dhe menaxhimi i tyre? Pyetja e radhës është se si qëndron udhëheqja në shkolla dhe çfarë qëndrimesh kanë ata ndaj ndryshimeve në shkollë?

Menaxhimi, ndryshimet dhe kushtet e punës i takojnë ndërgjegjësimit të vetëdijshëm të qëndrimit tonë që atë ta avansojmë.

Si objekt studimi në këtë punim magjistrature do të jetë:

MENAXHIMI, NDRYSHIMET DHE KUSHTET E PUNËS NË SHKOLLAT FILLORE TË PRIZRENIT

Ky studim synon të vërtetojë kushtet e punës dhe menaxhimin e tyre në shkollat tona në Kosovë e veçmas do të studiohen shkollat e regjionit të Prizrenit. Në këtë punim do të sqarohen:

- konceptet kryesore teorike shkencore për kushtet e punës dhe menaxhimin me ndryshime.
- në pjesën empirike do të jepen të dhëna nga konstatimet e hulumtimit të realizuar me udheheqësit aktual në shkolla në regjionin e Prizrenit.

Arsimi është një nga fushat më të rëndësishme të çdo shoqërie dhe të çdo sistemi. Përmes arsimimit shoqëritë dhe kombet ju transmetojnë pjesëtarëve të tyre dijen, kulturën, trashëgiminë kulturore, vlerat përmes të cilave shkon përpara shoqëria. Arsimi është edhe një nga fushat që, jo vetëm i prin shoqërisë, por edhe ndikohet fuqishëm prej saj dhe ndryshimeve shoqërore. Fakti që sistemet e arsimimit janë në ndryshim të përhershëm, nuk tregon paqendrueshmëri, përkundrazi ato shërbejnë për t'iu përshtatur sa më mirë ndryshimit të shoqërisë. Ashtu siç ka ndodhur edhe në sistemin tonë shkollor, ndryshimet e shpeshta të bëra këto njëzet vitet e fundit, kanë treguar se arsimi është munduar të përshtatet sa të mund me ndryshimet sociale në vendin tonë, por edhe me ato globale. Eksperimentimi në arsim nuk është diçka e keqe, por kur ky eksperimentim kalon caqet hapësinore dhe kohore, atëherë ai bëhet i dëmshëm dhe ndikon negativisht. Reformat e fundit në arsim dhe debatet që i kanë shoqëruar ato dëshmojnë për një rritje të ndërgjegjësimit të shoqërisë për problemet e arsimit dhe shkollës. Këto probleme duket se i përkasin gjithë shoqërisë dhe jo vetëm një pjese të saj.

Reformimi i arsimit tashmë ka prekur të gjithë sistemin arsimor dhe duket se po kulmon me ligjin për arsimin e lartë. Sot një drejtues shkolle apo drejtorja e saj pothuajse nuk kanë asnjë kompetencë për sa i përket administrimit të mjediseve shkollore. Një drejtor shkolle nuk mund menaxhojë dot mjedise shkollore sipas interesave të shkollës dhe komunitetit, sepse në radhë të parë shkolla nuk ka asnjë buxhet dhe nuk ka asnjë ligj që rregullon këto marrëdhënie. Kështu edhe nëse një drejtues do të bëjë përpjekje për të përmirësuar gjendjen në shkollën e tij, këto më shumë do të realizohen si favore për hatër të drejtorit sesa si punë dhe ndihmë për shkollën.

Këto janë disa nga mendimet e mia rreth reformimit të sistemit arsimor në vija të përgjithshme, të para në këndvështrimin e problematikave që janë të mundshme të zgjidhen pa pasur një kosto të lartë dhe pa dhënë efekte të padëshirueshme. Për këtë duhet një njohje dhe përhapje më e gjerë e informacionit të ri, që aktorët e këtyre ndryshimeve të dinë si dhe ku ta gjejnë veten në këtë sistem që është në reformim të vazhdueshëm.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Studimi synon të ekzaminojë, të vëzhgojë me kujdes, të kontrollojë kushtet e punës dhe menaxhimin (udhëhiqjen) në shkollat fillore në Prizren.

Drejtori i cili është njëri ndër faktorët kryesor për pranimin, zbatimin si duhet të bëhet menaxhimi i kushteve të punës në shkolla, ai edhe duhet të jetë konkurrent i vazhdueshëm në tregun e punës, ku vazhdimisht ndodhin ndryshime shoqërore, kulturore dhe krijuese.

Kushtet e punës dhe menaxhimi në shkollat tona duhet të merren si nevojë e pakontestueshme për t'i ndjekur rrjedhat e zhvillimit të shkencës dhe të teknologjisë.

Për t'i ndjekur këto rrjedha kushtet e punës duhet të jenë të nivelit më të lartë dhe ky është edhe qëllimi i hulumtimit që synojë ta ekzaminojë si është gjendja e kushteve të punës.

Si problem që e inicon këtë hulumtim janë pengesat, ndikimi i politikës në arsim, sepse edhe në arsim ka ndikim të madh politika. Ndonjëherë për shkak të ndërrimit të drejtorit ndalet një punë që ishte duke u procesuar dhe zhvilluar dhe duhet të presim deri sa të zgjedhet dikush tjetër.

Krejt kjo vjen nga mjedis i jashtëm me motive partiake-politike, që njeriun këtu tek ne e vlerësojnë sipas veprimeve partiake e jo sipas aftësive dhe arritjeve individuale.

Shkolla çdo herë ndodhet në ristrukturim e jo rikulturimi i individëve që të shihet transparenca dhe ndryshimet në shkolla.

Pra, këto dhjetë vitet e fundit në Prizren shkolla është bërë çdo herë nga veprimet partiake dhe asnjëherë nuk është zhvilluar puna deri në fund. Ka ngecur plani i një pune që kishte filluar të zhvillohet dhe asnjëherë nuk ka përfunduar, sepse s'kanë qenë serioz në punën që fillonin, por me këtë hulumtim do të vijmë në përfundim se sa kanë mundur të sigurojnë ata kushte të punës.

Sepse sipas drejtorëve që vinin në mes të punës, ata mendonin se me pozitën që kanë duhet të praktikojnë udhëheqje autokratike me stil detyrues dhe përcaktues që janë mjete që ndikojnë negativisht në shkolla.

Studimi synon:

- Të konstatojë se transparenca është faktor që ndikon në klimën pozitive në shkollë.
- të konstatojë se mjedisi i jashtëm me nuanca partiake ndikon negativisht në shkolla.
- si punohet në shkolla dhe në çfarë kushte.
- a ka hapësira të mjaftueshme të gjelbëruara në shkolla ku mund të dalin nxënësit
- infrastruktura e shkollës
- inventari i shkollës
- menaxhimi i procesit arsimor në shkolla.
- a posedon shkolla salla sporti, salla kompjuterike, bibliotekë, laboratorë etj.
- të konstatohet se sa merret parasysh qëndrimi i mësimeve, nxënësve dhe i prindërve në krijimin e vizionit.
- të konstatojë se udhëheqësve ju nevojitet autonomi dhe përkrahje.

Kujt mund t'i shërbejë studimi?

Ideja themelore e këtij projekti është; Ndryshimi dhe e drejta për arsim – edukim cilësor dhe të ofrojë një pasqyrë të burimit të pritjeve për arsim që kanë ndikim të drejtpërdrejt në arsimin dhe shkollat e Prizrenit. Në thelb, pritjet janë që të gjithë nxënësit do të marrin arsim cilësor, pavarësisht racës, gjinisë, aftësive fizike, aftësive mendore, përkatësisë etnike apo statusit shoqëror. Drejtori i shkollës ka rol qendror në përmbushjen e këtyre pritjeve. Pozita e tij/saj është si motori i një makine të madhe e të komplikuar. Nëse motori ndalon asgjë tjetër nuk punon, por nëse motori është i fuqishëm e tërë makina ka shumë fuqi dhe mund të bëjë shumë gjëra të mira.

- studentëve të këtij drejtimi mund t'iu realizohen sfidat që u dalin nga kultura e mjedisit të shkollave tradicionale ku ata janë të obliguar të kryejnë praktikën shkollore.

1. gjithëpërfshirja e nxënësve në arsimin e obligueshëm
2. procesit të zbatimit të Kurrikulës së re arsimore dhe
3. shërbimit pedagogjik e psikologjik

- drejtorëve për përmirësimin e sjelljes së tyre, si faktor kryesor për rregullimin e klimës në shkollë dhe rikulturimin e mësimeve për pranim të ndryshimeve si një domosdoshmëri që e imponon shoqëria e dijes në mileniumin e ri.

1. legjislacioni arsimor
2. udhëzim administrativ i veçantë dhe
3. mekanizmat për sigurimin e cilësisë.

KAPITULL I

1. ASPEKTI TEORIK

Menaxhimi, kushtet në shkolla dhe ndryshimet në Kosovë dhe në Prizren

Lidhur me menaxhimin e shkollave, kushteve të punës në shkolla kanë shkruar një numër i madh i njohësve të arsimit. Teoritë shkencore mbi menaxhimin bazohen në shkrimet shkencore¹ **Majkëll Fullan**, Djuk, Evans, Donaldson, ndërsa në Kosovë lidhur me çështjet e arsimit kanë shkruar Musa Kraja, në Maqedoni, Tahir Zajazi, **Hasan Jashari**, në Shqipëri Bardhyl Musai, Xheladin Murati, Musa Kraja etj., si dhe shumë shkencëtarë të tjerë, ku tregohet për menaxhimin dhe kushtet e punës si duhet të zhvillohet procesi arsimor, gjithashtu edhe për rikulturim.

Shkolla domethënien e vetë madhore në çdo shoqëri dhe shoqëria është e para në agjendën e saj të ndryshimeve strukturore që është i njohur në teori dhe praktikë, është procesi i periudhës së tranzicionit shoqëror.

Çdo ndryshim varet nga disa parakushte të cilat zakonisht janë themeluar në paragjykimet reale në të cilat funksionojnë institucionet. Pikërisht shkolla si institucion me rol shoqëror bazik me ristrukturimin e saj nxit shumë ngatërresa në mjedisin më të gjerë dhe më të ngushtë të bashkësisë shoqërore.

Në kushtet kur bëhen ndryshime është e domosdoshme që të nxiten ndryshime edhe në vetë shkollën si institucion që i referohet nevojës së ndryshimeve. Shkolla gjithnjë e më shumë bëhet faktor i rëndësishëm i ekzistencës tonë dhe sfidave të përditshmërisë tonë. Duke ditur se shkolla është prezente në jetën tonë, në familjet tona, por edhe në medime dhe me gjerë, të mësuarit si proces, manifestohet në çdo kënd të shoqërisë njerëzore. Duke u nisur prej kësaj, në masë të madhe hulumtuam format dhe metodat më të sofistikuar të punës dhe organizimit të instancave shkollore, që do të mundësojnë përkrahje efektive të zhvillimit teknik –shkencor. Menaxhmenti ose udhëheqja e shkollës është ajo që duhet të parashohë

¹ M.Fullan-Forcat e ndryshimit -menaxhimi dhe ndryshimet ne shkolla-faqe-9-M.Fullan-Forcat e ndryshimit -faqe-10-krijimi I mundesis per te fituar njohuri rreth ndryshimeve ne shkolla-mesuesit jane agjent te ndryshimit ne arsim dhe permiresimit te shoqerise.M.Fullan-Kuptimi I ri I ndryshimit ne arsim-faqe-51-Ndryshimi ne arsim-faktore,process,ndryshime ne arsim dhe gjitheperfshirje

ndryshimet. Për të arritur deri në përsosmëri në punën e shkollës dhe të çdo organizate tjetër, janë të nevojshme ndryshime të shpeshta.

Udhëheqja e suksesshme kërkon një proces të përgjegjesisë më të madhe në lidhje me kërkesat e personelit dhe mjedisit. Drejtorët e shkollave nuk duan që të thirren menaxherë, edhe pse ky nocion bëhet shumë aktual në ditët tona dhe është kënaqësi të qenit në pozitë të menaxherit dhe sidomos të pasurit sukses gjatë menaxhimit.

Analistët amerikan të menaxhimit të shkollës udhëheqin me një tezë shumë të njohur se, drejtori i shkollës është njeriu te i cili duhet të shkojnë dhe të zgjidhen të gjitha problemet që të tjerë nuk kanë mundur t'i zgjidhin. Piter Draker menaxhimin e definon si proces të radhës dhe bashkimit të pjesëve të një tërësie.

Menaxhimi i qëllimit moral dhe agjentëve të ndryshimit është thelbësor për arritjen e një ndryshimi produktiv në arsim. Është e nevojshme ta shqyrtojmë secilën prej tyre nga afër dhe të shpjegojmë marrëdhënien e tyre organike .

Shkolla është i vetmi institucion në vendin tonë që është posaçërisht i ngarkuar me detyrën që t'ju mundësojnë të rinjve njohje të disiplinuar me të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore; botës si sistem biologjik dhe fizik, sistemet vlerësuese dhe të bindjeve, sistemet e komunikimit, sistemet shoqërore, politike dhe ekonomike e të cilat përbëjnë fshatin botëror dhe vetë mbijetesën njerëzore.

Mësuesit janë agjentë të ndryshimit në arsim dhe të përmirësimit të shoqërisë. Menaxhimi i shkollës bashkëkohore dhe roli i shkollës përqendrohet në ata sektorë të zhvillimit që kanë në radhë të parë rëndësi strategjike për ekonominë dhe transformimin e gjithëmbarshtëm shoqëror. Është gjithashtu i njohur fakti se shkolla që të realizojë këto funksione duhet edhe vetë të reformohet dhe bashkëkohësohet. Ndryshimi i shkollës, siç thamë, është proces i pandërprerë; që ai të jetë i qëndrueshëm dhe në funksion të përparimit cilësor të jetës në të, ndryshimi duhet të menaxhohet (drejtohet). Kuptimi i ndryshimit në arsim M.Fullan.

Në qoftë se kjo nuk ka ndonjë kuptim, atëherë shpëtojmë nga një mal me telashe, sepse nuk ka nevojë që ta kërkojmë ndryshimin. Në tekstet e lartpërmendura koncepti i menaxhimit elaborohet në mënyra të ndryshme. Shumica e autorëve bazohen në filozofinë e menaxhimit si teori dhe praktikë shoqërore. Nëse i referohemi Majkëll Fullan ai në librin e tij *Forca e ndryshimit*, në pjesën e parë do të sqarohet me hollësisht rikonceptimi teorik për "Menaxhimin, ndryshimin dhe kushtet e punës në shkollat fillore".

Në këtë pjesë, pra të pjesës teorike për kushtet e punës dhe menaxhimin në shkolla me aftësi dhe faktore kyç për konceptin, qëndrimin e individit, arsimimi si faktor që ndikon në ndryshimet për pranimin e ndryshimeve të punës me konceptin motivim.

Gjithashtu te pjesa e parë do të bëhet gjithëpërfshirja e katër shkollave, se ku ndodhen, si menaxhohen me çfarë pasoja përballen, si i kanë kushtet për të punuar, a kanë ngecje dhe vështirësi në procesin arsimor dhe me çfarë vështirësi ballafaqohen.

Në pjesën e dytë do të sqarohen kuptimet e koncepteve të rolit të udhëheqësit dhe karakteristikat e udhëheqësit.

Në pjesën e tretë sqarohen konceptet, funksionet e drejtorit, detyrat e drejtorit, stilet e punës dhe konceptimet për udhëheqje dhe udhëzime për udhëheqje efektive.

Në pjesën tjetër jepet ecuria në realizimin e objektivit të këtij hulumtimi, metodologjia e punës hulumtuese, objekti i studimit, hipoteza, modeli i hulumtimit, përgatitja dhe organizimi. Gjithashtu jepen rezultate empirike rreth menaxhimit, ndryshimit dhe kushteve të punës në shkollat fillore të Prizrenit.²

Dhe në pjesën e fundit, jepen përgjithësime në vërtetimin e hipotezave.

Aspekt metodologjik

PYETJET DHE HIPOTEZAT E HULUMTIMIT

Hipoteza kryesore në këtë hulumtim është:

Në konceptin bashkëkohor të **Menaxhimit, ndryshimit dhe kushtet e punës në shkollat fillore të Prizrenit**, a ka rol vendimtar rregullimi i klimës në shkollë.

Kemi supozuar se në dhjetë vitet e fundit shkollat tona janë nën ndikimin e risive dhe menaxhimin me ndryshime. Kjo ka anët e forta dhe të dobëta, mundësitë dhe rreziqet e veta.

Aftësitë menaxhuese të organeve përkatëse arsimore kanë ngritje të vazhdueshme profesionale dhe kadrovike dhe janë të një kualiteti më të lartë në shkollat brenda regjionit.

² Hasan Jashari -Funksionet e arsimit-faqe 19-integrim shoqërorë dhe përgatitje për punë.-faqe-130,menaxhimi i shkollës,shkolla gjithënjë e më shumë bëhet factor i rëndësishëm i egzistencës dhe sfidave,faqe-90. Shkolla dhe imazhi i saj-shkollat gjithmonë kanë qenë objekte të veqanta dhe specifike

- Hipoteza ndihmëse: mjedisi i brendshëm e pranon drejtorin për shkak se ofron kushte të mira dhe ndërvepron me agjentët në shkollë.

Pra, për të mirën e kushteve të punës që ato të zhvillohen me mjedise të shkollave evropiane dhe t'i plotësojnë të gjitha kushtet.

- Hipoteza ndihmëse: mjedisi i jashtëm përmes involvimit të politikës në institucionet shkollore a ndikon negativisht në shkolla.

METODAT DHE TEKNIKAT E HULUMTIMIT

Studimi i **Menaxhimit, ndryshimit dhe kushtet e punë në shkollat fillore të Prizrenit**, është objekt i këtij hulumtimi.

Objekti i këtij studimi përshtatet me qasjen në strategji kërkimore të metodës kauzale. Modeli që praktikohet në këtë studim demonstroi shembull të natyrës analitike shkencore. Objekti i këtij studimi fokusohet në menaxhimin e kushteve të punës në shkollat tona, ku vazhdimisht është konkurrenca e pranishme dhe dinamika e konkurrencës. Drejtori si faktor kyç ndikon në krijimin e klimës pozitive në shkollë, ku çdo njëri do ta ndjejë veten të dobishëm dhe pjesëmarrës në arritjet e përbushjes së qëllimeve dhe të vizionit.

Për të hulumtuar dhe studiuar këtë temë në mënyrë të gjithanshme, kemi përdorur këto metoda të hulumtimit:

- 1. Metoda përshkruese**
- 2. Metoda statistikore**
- 3. Metoda krahasuese**
- 4. Metoda e bisedës**
- 5. Case study**

METODA PËRSHKRUESE

Me këtë metodë kemi përshkruar dukurinë që është objekt hulumtimi, gjendjen e shkollave fillore në Prizren dhe kemi parë gjendjen e kushteve të punës në të cilën ndodhen. Gjithashtu dhe menaxhimin e ndryshimeve se si kanë punuar këto shkolla në këto dhjetë vitet e fundit.

Po ashtu, kemi parashtruar të dhëna që kanë të bëjnë me këto dhjetë vitet e fundit dhe rezultatet, opinionet, rekomandimet, pasojat dhe ndikimet.

METODA STATISTIKORE

Metoda statistikore na shërben për të nxjerrë dhe për të ardhur në përfundim të një hulumtimi dhe për të krahasuar të dhënat e kërkuara me përqindje përmes tabelave. Me këtë metodë hulumtojmë, studiojmë, analizojmë të gjithë materialin e kërkuar përmes opinionëve të të anketuarve.

Grumbullojmë fakte, informacione me rëndësi rreth problemit, vëzhgohet situata dhe problemi i caktuar.

METODA KRAHASUESE

Kjo metodë zë një vend të rëndësishëm në këtë fushë, ngase me këtë metodë bëhet krahasimi i procesit arsimor në menaxhim të ndryshimeve dhe të kushteve të punës në shkollat fillore, se si kanë qenë dhe ku gjenden tani gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit në Prizren. Ambiente për hulumtim janë përzgjedhur ambientet e shkollave fillore të regjionit të Prizrenit, prej nga dalin rezultatet, opinionet, rekomandimet, pasojat etj.

Të gjitha këto vinë duke filluar nga ndikimi i kushteve të punës në shkolla dhe menaxhimi i tyre. Përgjegjësia është te drejtori, sepse ai është faktori kyç që i pranon ndryshimet dhe e menaxhon shkollën me hapa më të mirë dhe më të sigurt.

Pra, me këtë metodë mund të bëjmë këtë krahasim të shkollave, si ishin ato, në çfarë kushtesh kanë zhvilluar procesin arsimor dhe si është menaxhuar shkolla para futjes së ndryshimeve dhe si i kanë pranuar ndryshimet, sepse aspak nuk është e lehtë të aplikohen ato ndryshime, ngase shkollat nuk qendronin mirë me kushtet e punës dhe nuk mund të aplikohen ato ndryshime për pak kohë.

Gjithashtu, me këtë metodë kemi të bëjmë me infrastrukturën, inventarin dhe të gjitha problemet e shkollës, që përmes këtij hulumtimi do të nxjerrim krahasimet.

METODA E BISEDËS

Kjo është një metodë që është përdorur gjatë këtij hulumtimi me drejtorët e shkollave, me mësuesit dhe me nxënësit, duke synuar të pasqyrojmë nivelin e kënaqjes së tyre me

procesin arsimor që zhvillohet në shkollën e tyre dhe a i kanë të plotësuar të gjitha kushtet e punës për mësim sa më cilësor.

Gjithashtu, mësimdhënesit gjatë bisedës janë pyetur se a janë të kënaqur me kushtet dhe menaxhimin, gjithashtu edhe ndryshimet që i ofron shkolla ku punojnë ata.

Bashkëbisedimet janë bërë me qëllim që të hetojmë dallimet në mes të deklarimeve gojore dhe rezultateve që janë, rreth zhvillimit të praktikave të kërkuara në lëndën e hulumtimit.³

ETIKA E HULUMTIMIT

Hulumtimi do të bazohet në të dhëna zyrtare nga njerëzit kompetent, si dhe përgjegjës për sigurimin e cilësisë së arsimit dhe përmirësimit të kushteve të punës në shkollat fillore në Kosovë. Në bazë të lejes së tyre edhe do të publikohen.

REZULTATET E PRITURA

Ne kemi zgjedhur strukturë reprezentative në përbërjen e pesë shkollave fillore në regjionin e Prizrenit. Qëllimi ishte që të gjenden qendrime pozitive të drejtorëve për udhëheqje në shkollat e këtij rajoni.

Që të realizohet ky hulumtim dhe të jetë sa më objektiv, pra me ndihmën dhe sjelljen e mirë ndaj mësimdhënësve dhe drejtorëve, arrita ta bëj këtë hulumtim dhe të vijë deri tek këto rezultate.

Ky hulumtim nxjerr në pah nevojat dhe prioritetet e domosdoshme të menaxhimit, ndryshimit dhe të kushteve të punës me sigurimin e cilësisë së arsimit nga ana e drejtorëve dhe mësimdhënësve.

³ **Marrë materiale në internet dhe në disa botime shkencore**

1.1. MENAXHIMI I SHKOLLAVE DHE NDRYSHIMET NË KOSOVË DHE PRIZREN

Koha në të cilën jetojmë karakterizohet me ndryshime të shpejta teknologjike dhe shoqërore, politike dhe ekonomike dhe pse jo të vlerave, të pikëpamjeve e të ngjashme.

Marrëdhëniet që paraqiten ndërmjet menaxhimit dhe dryshimit janë kauzale. Aty bëhet fjalë për ndryshim, zhvillim, imperativa të ndryshimit të kushtëzimit që sjellin ndryshime, determinante dhe faktorët që sjellin ndryshime.

Studimi i marrëdhënieve ndërmjet menaxhimit dhe ndryshimeve është një nevojë⁴ e kohës, sepse është i domosdoshëm harmonizimi i veprimeve për realizim të ndryshimeve. Vend të veçantë në zhvillimin e shoqërisë zë shkolla dhe arsimitari. Aftësimi i arsimtarit, si faktor aktiv dhe bartës i rolit arsimor, në vete përfshin shumë më tepër prej arsimimit formal të cilën ai e merr në institucionet arsimore.

Aftësimi i arsimtarit për punë në kushte të reja në shkollë të reformuar dhe për modernizimin e saj të qëndrueshëm, duhet të kuptohet si shumësi e diturive dhe shkathtësive të fituara për të çuar proceset përpara.

Nga kjo rrjedh supozimi themelor se arsimimi dhe aftësimi i vazhdueshëm i arsimtarit paraqet faktorin themelor për rritje, përmirësimin, modernizimin dhe ndryshimin e shkollës. Kështu, duke e ndryshuar atë, duke e bërë më efikase, zhvillohet edhe vetë arsimtari

Prandaj, shtrohet si nevojë e domosdoshme

- aftësimi për aplikimin e risive
- zbatimin e njohurive shkencore për qëllime arsimore
- eliminimin e qasjeve tradicionale në mesim e në shkollë
- aftësimi për mësim bashkëkohor në shkollë
- zbatimin dhe vlerësimin e ndryshimeve dhe risive

Të theksojmë se cilësia e punës së arsimtarit, kyqja e tij dhe gatishmëria të bartet me probleme, alternativat zhvillimore, strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies, është njëri nga faktorët qenësor për ndërtimin e shkollës cilësore.

⁴ Materiali shkëputur nga interneti /www.google.com dhe disa burime tjera si gazeta dhe revista shkollore rreth menaxhimit dhe ndryshimit në arsim dhe nga disa ese rreth ndryshimeve të bëra viteve të fundit në Kosovë/Prizren

Shkolla ndodhet në proces të vazhdueshëm ndryshimi.

Paradigmat e reja shoqërore, kulturore, shkencore sociale i imponojnë domosdo ndryshimet e shkollës dhe bartësve të rolit edukativ në të, pra të arsimit. Shkolla duhet të ndryshojë dhe ajo mundëson ndryshimin e gjithëmbarshtëm

Ndryshimi i saj duhet të bëhet në drejtim të:

- krijimit të prespektivave të reja të nxënësve, studentëve, arsimtarëve, në përgjithësi të jetës së njeriut;
- përgatitja e gjeneratave të bëhet për një shoqëri të dijes, për një tip të ri të punës

Në bazë të ndryshimit të shkollës bëhet edhe ndryshimi i arsimit.

Për të çuar përpara proceset zhvillimore arsimit duhet të:

- perceptojë ndryshimet në shkollë
- të bëhet menaxhues i ndryshimeve
- ndryshimet të shikohen si sfidë, provokim për cilësi

Procesi i ndryshimeve tash ka filluar.

Ndryshimi i arsimit dhe ndryshimet në shkollë janë nevojë urgjente e shoqërisë për disa arsye:

- përforcimi i rritjes intelektuale
- promovimi i institucionit efektiv të shkollës
- përparimi i mësimin dhe të mësuarit

Me ndryshim të shkollës kuptojmë përsosjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarive pedagogjike, investimet në programe dhe përmbajtje të edukimit dhe ngritjen e cilësisë së punës edukative për një përshtatje sa më të mirë me shndërrimet që i pëson koha. Ndryshim të arsimit dhe ndryshim të shkollës duhet bërë në bazë të filozofisë së caktuar pedagogjike.

Ndryshimet e shkollës janë rezultate dhe pasojë e:

- ndryshimeve radikale në shoqëri
- ndryshimet në qasjen ndaj edukimit dhe arsimit
- qasje dhe mënyra të reja të sjelljes ndaj nxënësit
- kahet evropiane dhe botërore në fushën e arsimit dhe të shkollës

1.2. Menaxhimi i ndryshimeve në shkollë

Jetojmë në një botë që ndryshon vazhdimisht. Fullan, një nga studiuesit më në zë të teorisë dhe praktikës së ndryshimit, shkruan: "Kjo është një botë në të cilën ndryshimi është një udhëtim ku pikëmbërritja është e panjohur, ku problemet janë miqtë tanë, ku kërkimi i ndihmës është shenjë e forcës, ku nismat e njëkohshme nga lart-poshtë dhe poshtë-lartë përzihen me njëra-tjetrën, ku kolegjaliteti dhe individualizmi bashkëjetojnë në një tension produktiv. Vetëm njerëzit që zotërojnë njohuritë dhe aftësitë për ndryshim mund të realizojnë një ndryshim të efektshëm.

Pra, ndryshimi i vërtetë, qoftë ky i dëshiruar ose jo, përfaqëson një përvojë serioze vetjake dhe kolektive, që karakterizohet nga paqartësia dhe pasiguria; dhe nëse ndryshimi është i suksesshëm, ai mund të sjellë një ndjenjë zotërimi, arritjeje dhe zhvillimi profesional.

Ndryshimi realizohet nëpërmjet dy lloj procesesh:

Procesi diagnostikues përfshin tre hapa:

Përshkrimi i tablosë aktuale të dukurisë, çështjes, situatës, institucionit.

Matja e dukurisë, e çështjes nëpërmjet vrojtimit, intervistimit, anketimit, testimit. Specifikimi i problemeve dhe i nevojave duke krahasuar mospërputhjen e tablos së vrojtuar me atë ideale, përcaktimin e shkaqeve të kësaj mospërputhjeje. Ndërhyrja për të realizuar ndryshimin përmban tre hapa: Zgjedhja e elementeve ku duhet ndërhyrë, të nxjerra nga diagnostikimi.

Ndryshimi i roleve dhe i normave për të institucionalizuar procedurat dhe sjelljet e reja.

Vlerësimi i suksesit të ndërhyrjeve duke rimatur funksionimin aktual.

Menaxhimi i shkollës

Drejtuesi i shkollës siguron dhe menaxhimin efektiv të shkollës dhe kërkon rrugë të reja për përmirësimin e strukturave dhe funksionimit të institucionit. Gjithashtu, drejtuesi duhet të synojë të ndërtojë një institucion të suksesshëm nëpërmjet bashkëpunimit efektiv me aktorët e tjerë.⁵

⁵ XHELADIN MURATI-Ndryshimi i arsimit dhe ndryshimet në shkollë, faqe58

-Ndërtimi i shkollës bashkëkohore- roli i shkollës, zhvillimi, rëndësia strategjike për transformim shoqëror, f 182

Drejtuesi ka njohuri mbi:

- teoritë bashkëkohore të menaxhimit të shkollës (menaxhimin e projekteve që lidhen me planifikimin dhe realizmin e ndryshimeve, ndërtimin e politikave nëpërmjet bashkëpunimit, konsultimit dhe rishikimit etj.)
- parimet dhe modelet e vetëvlerësimit.
- parimet dhe strategjitë e përmirësimit të shkollës.
- aspektet ligjore, që lidhen me menaxhimin e shkollës (paketa ligjore që ka lidhje me shkollën).
- përdorimin e teknologjive të reja në nxitjen e efektivitetit institucional.

Drejtuesi angazhohet dhe siguron:

- -analizën e të dhënave dhe interpretimin e rezultateve.
- -menaxhimin e drejtë të stafit dhe të burimeve.
- -motivimin personal dhe të të gjithë stafit.
- -bashkëpunimin me aktorët e tjerë, për të forcuar kapacitetet organizative të shkollës.
- -ndjek dhe pasqyron në planifikimin e punës ndryshimet e dokumentacionit shkollor
- -harton dhe zbaton plane dhe politika zhvillimi të qarta e të mbështetura në tregues për zhvillimin e shkollës
- -menaxhon efektivisht burimet financiare dhe njerëzore për të arritur qëllimet dhe prioritetet edukative të shkollës
- -konsolidon personelin shkollor, kulturën e menaxhimit me objektiva të matshme
- organizon vëzhgime kontrolle dhe bën vlerësimin sistematik për verifikimin e efektivitetit të vendimeve.

Menaxhimi i ndryshimeve në shkollë- ndryshimi i shkollës si proces i pandërprerë, përcaktimi i ecurisë së futjes së ndryshimeve.

1.3.Menaxhimi dhe ndryshimet

Fjala menaxher rrjedh nga fjala angleze manage që në gjuhën shqipe do të thotë udhëheq, administroj, drejtoj.

Menaxhim është kategori universale të menaxhosh do të thotë, të nxitësh, të intervenosh, të korrighosh, të përkrahësh, të motivosh.

Kjo ndodh në çdo veprimtari njerëzore, karakteristikë themelore e një shoqërie bashkëkohore është menaxhimi i institucioneve. Menaxhimi në praktikë ekziston prej kur ekziston civilizimi dhe do të ngel cilësia themelore dhe qendrore derisa ekziston civilizimi. Shkencës për menaxhim i kushtohet dhe i vihet një theks dominant në shoqërinë e industrisë dhe teknologjisë. Menaxhimi është një proces universal, proces themelor për arritjen e punës nëpërmjet tjerëve.

Kur flasim për menaxhimin në arsim, atëherë duhet t'i parashohim çështjet si në vijim: menaxhimi është proces e jo koncept.

Sipas mendimit tradicional menaxhimi parashih vetëm strukturën udhëheqëse, por jo edhe personelin në përgjithësi, prandaj menaxhimi si koncept asocion në status dhe fuqi. Sipas mendimit modern menaxhimi është veprimtari që kryhet me veprim të individëve nën drejtimin e një individi përgjegjës, i cili ua mundëson kushtet për tu kryer ai veprim.

Menaxhimi është proces ku individët aftësohen për të gjetur zgjidhje të çështjeve të çdo situatë

- kuptimi i menaxhimit është proces i cili kërkon pranim, integrim dhe krahasim. Ai ekziston si rezultat i zbatimit të prezentimit të praktikës efektive ose si aplikim i modeleve teorike në praktikë që zbatohen në situatë specifike në kontekst të caktuar.

- menaxhimi kërkon të mësohet të jesh pjesëmarrës në debate për qëllimet dhe vlerat e shkollës.

- njerëzit mësojnë të bëhen menaxher të suksesshëm përmes procesit të drejtimit. Interaksioni në mes praktikës dhe teorisë është faktorë me mundësinë që një individ t'i informojë tjerët dhe t'i zgjerojë idetë e veta. Përmirësimi i gabimeve me mësim teorik dhe praktik.

- menaxhimi me ndërveprim me individët tjerë të personelit sjell harmonizim

- menaxhimi nënkupton pranim, qetësim, zbatim dhe institucionalizim i risive të ndryshimeve të shumta dhe të shpeshta. Mësimdhënësit duhet të motivohen për dobinë që sjell risia që i largojnë nga ngarkesat dhe situatat stresuese.

1.5 -Kuptimi i konceptit ndryshim



Në dekadat e fundit për realizimin e misionit në shumë institucione të botës e bënë të domosdoshëm ndryshimin. Ndryshimet i detyrojnë edhe shkollat që të ndryshojnë.

Ndryshimet janë të shumta në ditët e sotme.

Ndryshimet në institucione bëhen në strukturën e brendshme, të jashtme dhe në udhëheqjen e shkollës. Ata janë të nevojshëm për përmirësimin dhe lehtësimin e mesimdhënies, për të mësuarit e nxënësve me metoda moderne. Ndryshimet në shkollë bëhen që të përmirësohen kushtet në shkollë për mesimdhënie dhe përmirësimin e të arriturave të nxënësve.

Megjithatë, shumë nga ndryshimet kanë dështuar dhe nuk i kanë dhënë rezultatet e duhura, për shkak të shkaqeve të ndryshme, të cilat duhet të kërkohen në bashkëveprimin në mes të të punësuarve dhe udhëheqësve të tyre, mungesa e ndërveprimit dhe mirëkuptimit, rezistenca nga të punësuarit ndaj iniciativës për ndryshim për shkak frikës nga risitë.

Vitet e fundit mesimdhënësit kanë ndjekur shumë trajnime për mesimdhënie moderne, por institucionalizimi i dobët reflektohet në praktikë.

Pasi mbarojnë financimet nga jashtë vërehet se rikthehet mënyra e vjetër e punës. Ndoshta nga paqartësia dhe pakuptueshmëria e rrisë së ndryshimit vjen deri në konfuzion, mbingarkesë dhe ndjenjë të ulët efektiviteti.

Kuptimi dhe qartësia e risive të ofruara i motivon mesimdhënësit për të zbatuar dhe institucionalizuar, njohuritë ndihmojnë për të ndërtuar dije dhe për të zgjidhur probleme të vazhdueshme, të cilat vazhdimisht paraqiten.

Prandaj, para se të fillohet me ndryshime duhet të dihet se çfarë efekti do të sjell risia e ofruar çfarë ndikimi do të ketë në performancën e organizates, çfarë ndikimi do të ketë tek nxënësit dhe sa investim do të duhet që të arrihet ndryshimi.

Drejtori duhet ta luajë rolin e trajnuesit, t'ju ofrojë ndihmë dhe sqarime të nevojshme mësimdhënësve. Ai duhet vetë ti sigurojë kushtet e nevojshme, të cilat do të mundësojnë në zhvillimin dhe përdorimin e ndryshimit në punën e përditshme. Nga aftësia e drejtorit si menaxher dhe udhëheqës varet gjallëria dhe institucionalizimi i rrisë së ndryshimit.

1.6. SHKOLLA SI INSTITUCION KU NDODHIN NDRYSHIME

Ndryshimi i klimës pedagogjike në shkollë duhet të ndryshojë në kahe pozitive të jetë entuziazmes, optimist, pa konflikte e mosmarrëveshje, pa stres e depresion dhe pa provokime në pikëpamje të menaxhimit, strukturës dhe vështirësisë.

Klima pedagogjike e punës në shkollë ndryshohet me hartimin e projekteve zhvilluese për ndryshim të ambientit dhe të jetës në shkollë, si projekt për rregullim estetik të shkollës projekte për modernizimin e procesit mësimor, projekte për nxitjen, motivimin e nxënësve projekte për respektimin reciprok të subjekteve në shkollë etj.

Ndryshimi i klimës në shkollë bëhet edhe nëpërmjet përmirësimit të pajisjeve në shkollë, ndërtim të shkollës atraktive, komunikim i hapur dhe i lirë në shkollë.

Në komunikimin midis arsimtarit dhe nxënësit dhe subjekteve të tjera të lejohet mendimi ndryshe. Debati i lirë respekton të gjithë pjesëmarrësit në diskutime, u jep nxënësve mundësi dhe hapësirë të afirmojnë vetëveten, të pasurohen me ide të reja, por gjithmonë duke respektuar njëri - tjetrin, duke treguar sa më shumë tolerancë midis nxënësit dhe arsimtarit.

Shkolla, varësisht nga resurset, duhet të përcaktojë vizonin, të ketë parullë e cila do të udhëzojë drejt pyetjeve që ka shkolla dhe drejt veprimtarisë së saj të vërtetë.

Qëllimi i ndryshimit të klimës pedagogjike është që nxënësi të ndihen mirë në shkollë, sepse atëherë ata do të ndryshojnë dhe do të mësojnë më mirë.

Ndryshimet në arsim dhe në institucionin shkollë, imponojnë përmbajtje të reja, mënyra dhe modele të reja të punës, organizim dhe qasje të re.

Ndryshimet në shkollë kapin dimensione dhe segmente të ndryshme.

Ndryshimet në strukturën e brendshme të shkollës

Shkollat edhe pse funksionojnë me ligje, plane e programe të përbashkëta, ato dallojnë bukur shumë ndërmjet veti; dallon shkolla e viseve urbane nga shkolla e viseve rurale, madje

dallojnë shkollat edhe në kuadër të një qyteti apo rajoni. Shkollat dallojnë nga njëra - tjetra me arkitekturën e ndërtesës, me numrin e nxënësve, me veprimtarinë e prindërve në të, me lidhjen e arsimtarëve me nxënësit, me veprimtarinë pedagogjike të arsimtarit, me suksesin e nxënësve, me klimën pedagogjike, me aspektet sociale në shkollë, me menaxhimin e punës edukative, me zbatimin e teknologjive mësimore, me projektet dhe strategjitë e punës etj.

Shkolla vepron në ambient të caktuar në të cilën veprojnë faktorët social dhe kulturor. Këta faktorë nga njëra anë e mundësojnë zhvillimin dhe ndryshimin e shkollës dhe në të njëjtën kohë bëjnë pengimin e përparimit të saj.

Shkollat që bëjnë ndryshime shkojnë në hap me kohën, krijojnë alternative, kurse ato që punojnë pa ndryshime, konservojnë qasjet tradicionale. Shkollat ndryshojnë si reflektim i faktoreve të ndryshëm, e ndryshimet japin shanse atyre që ekzistojn, të zhvillohen, të kenë frymë të moderuar të punës. Ky është parimi themelor i verifikuar në historinë e shkollës. Ndryshimi i shkollës bëhet duke zbatuar projekte të reja me të cilat përparohet puna edukative.⁶



Ndryshimi nuk është ngjarje por proces. Prandaj shkolla duhet tu përshtatet ndryshimeve shoqërore, vlerave të reja, kërkesave bashkëkohore, kurse arsimtari të ndryshojë në bazë të vlerave të shkollës, të punës dhe shkollës t'i japin dimension evropian.

⁶ Bardhyl Musai -Metodologjia e mësimdhënies - faqe 34.synimet , qëllimet dhe objektivat e ndryshimeve në shkolla dhe në mësimdhënie ,sepse mësimdhënia është një process i organizuar dhe i orientuar drejt një qëllimi të caktuar -faqe 37-përcaktimi i kushteve -pas ndryshimeve që janë shumë me rëndësi hapi i dytë janë përcaktimi i kushteve që paraqesin rrethana.

Ndryshimet në shkollë janë të domosdoshme, për këto shkaqe nëpër shkolla kryesisht ende dominon organizimi tradicional i jetës dhe punës së nxënësve, klima pedagogjike në të konservon raporte të vjetëruara, plan-programet mësimore janë shumë të unifikuara, ato kërkojnë më tepër fleksibilitet dhe decentralizim.

Ndryshimet të cilat mendoj se duhet berë, janë proces i vazhdueshëm dhe ato kahezen në disa drejtime, demokratizimin e jetës dhe klimës në shkollë, profesionalitetin dhe autonominë e arsimit (aftësia e arsimit për zgjidhjen e pavarur të metodave dhe të veprimeve në shkollë).

Kushtet e reja kërkojnë shkollë efikase e cila veçohet me cilësi multidimensionale në organizim fleksibël të jetës në to, programe fleksibile të mësimin, menaxhim bashkëkohor me shkollën, organizim, strukturë dhe metodologji bashkëkohore, arsimtar kreativ me kompetenca profesionale, mësim problemor, kooperues, ekipor, të programuar ku dominante është qasja individuale ndaj nxënësit, pozitë adekuate të nxënësit në shkollë-subjekt aktiv.

Me parë konstatojmë se ndryshimet janë të nevojshme nëse duam që shkolla të jetë efikase dhe bashkëkohore. Mendimi ynë është se shkolla ndryshon dita me ditë, madje në segmente dhe dimensione të ndryshme.

Shkolla ndryshon, ashtu siç ndryshon shoqëria, në përputhje me nevojat e kohës e të zhvillimit shkencor-teknik dhe teknologjik.

I tërë procesi i aplikimit të ndryshimeve dhe risive në shkollë mbështetet në hartimin e metodologjisë për ndryshimin e saj (definimi i qëllimeve, planifikimi, programimi, drejtimi, analizimi i gjendjes, kërkimi, zbatimi i rezultateve kërkimore).

Metodologjia e ndryshimeve të shkollës mbështetet në projektimin, pritjen, parashikimin dhe dinamikën e ndryshimeve.

Klima pedagogjike në shkollë varet nga faktorë të shumtë të jashtëm e të brendshëm. Faktorët e jashtëm, rrethanat fizike dhe sociale ku vepron shkolla, kurse faktorët të brendshëm.⁷

⁷ M.Fullan-Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim -faqe52-kuptimi i ndryshimit në arsim-problemi i përgjithshëm i kuptimit të ndryshimit - ndryshimi mund të ndodhë ose sepse na imponohet ose sepse ne marrim pjesë vullnetarisht madje edhe e fillojmë ndryshimin kur ndeshemi në paknaqësi, mosperputhje ose që nuk durohen në gjendjen tonë të tanishme.faqe 86-faktoërt që ndikojnë mbi fillimin e ndryshimeve-procesi i fillimit është qasti kur prëgatiten kushtet për zbatimin dhe vazhdimësin.

Organizimi dhe shkolla

Trajtohen rrethanat fiziologjike dhe psikike të partnerëve në shkollë.

Dallohet për veprimin e saj social dhe pedagogjik, sa që ajo trajtohet si institucion ku kultivohet individi, njeriu.

Kërkimi në shkollë synon studimin e proceseve që realizohen brenda shkollës dhe të klasës për të marrë masat e domosdoshme për të kuptuar dhe ndryshuar realitetin në të.

Shkolla ndodhet në process të vazhdueshëm ndryshimi. Paradigmat e reja shoqërore, kulturore, shkencore e sociale e imponojnë domosdoshmërinë e ndryshimit të shkollës (fizionomisë së jashtme dhe klimës së brendshme) dhe të bartësve të rolit edukativ në të, pra të arsimarit.



Arsimi dhe shkollat në përgjithësi, duhet në mënyrë përkatëse të reagojnë në kushtet e ekonomisë së tregut, sepse vetëm në atë mënyrë do ta forconin vitalitetin dhe pozitën e tyre të rëndësishme. Kjo imponon nevojën për reforma të arsimit të mesëm profesional, me qëllim që i njëjti të përshtatet në kushtet, nevojat dhe rrethanat e reja të zhvillimit shoqëror ekonomik të shoqërisë qytetare.

Kjo do të ndikonte që të bëheshin profesionistë të vërtetë që do të sjellin ndryshime të vazhdueshme të cilat do të mundësonin që të përfitojë ekonomia e tregut dhe në vend të kuadrove të deritanishme jo profesionale të nxirren kuadro me të arsimuara, më fleksibël, më të aftësuar dhe me profesional, që në kushtet e shoqërisë së bazuar në dije dhe konkurrencë do të mund të përballojnë me sukses çdo problem në proceset e gjithanshme shoqërore dhe ato jetësore të punës.

Sigurimi i kualitetit përfshin mekanizma seleksionues dhe vlerësimin e kualifikimeve të nxënësve, studentëve, arsimtarëve tipet dhe kohëzgjatjen e programeve mësimore, duke u

zgjeruar në vlerësimin e materialeve të mësimdhënies, mjeteve, laboratoreve, teknologjive të komunikimit, librarive etj.

Në të ardhmen kualiteti i arsimit të lartë do të mbështet pikërisht në modelet interaktive të mësimdhënies dhe të përvetësimit të njohurive që do të përcillet me mobilitet më të madh të arsimtarëve, përgjegjësive të tyre, por edhe karrierën e tyre.

Në kuadrin e determinimit ndërkombëtar të arsimit qëndron edhe aspekti i bashkëpunimit ndërfqinjësor. Në këtë kuadër duhet të rritet bashkëpunimi formal dhe jo formal në lëmin e arsimit midis Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës. Ky bashkëpunim duhet të jetë katalizator i suksesit dhe cilësisë në arsimin e të gjitha niveleve, me theks të posaçëm në arsimin universitar (në programe, kurrikula, tekste shkollore, tekste universitare dhe shkencore, metodologji pune, vlerësim dhe të ngjashme).

Bashkëpunimi i mirëfilltë i politikave arsimore dhe institucioneve arsimore midis këtyre vendeve fqinje do t'i identifikojë problemet themelore të zhvillimit të arsimit dhe të sigurisë së cilësisë në arsim.

Rritja e bashkëpunimit arsimor është me interes reciprok, sepse ofrohet mundësia që bashkërisht të ecet përpara në ndërtimin e shoqërisë teknologjike dhe demokratike. Bashkëpunimi krijon hapësirë dhe mundësi për unifikim të politikave arsimore, të vlerave dhe simeve arsimore, të potencialeve shkencore, të ideve dhe koncepteve pedagogjike, të strategjive dhe reformave arsimore, si dhe të këmbimit të përvojave për cilësi në arsim.

Vlerësimi i nxënësve, - vlerësimi real i të arriturave të nxënësit, që shprehet nëpërmjet notimit, për nxënësit dhe jetën e tyre shkollore, paraqet moment kritik. Por, vetë notimi nuk mbaron me aktin e vlerësimit të dijeve dhe me paraqitje të notave, por edhe ai akt, si rrjedhojë ka edhe konsekuenca të metutjeshme shoqërore.

Në interes për procesin e hulumtimit tonë është shqyrtimi i kësaj problematike nga një këndvështrim tjetër. Me saktësi përmbledhen dijet e nxënësit dhe ky proces ka ose jo verifikim më të gjerë shkencor.

Në shkollat fillore ekziston edhe notimi me shkrim. Kjo mënyrë e të notuarit është e njëjtë gati në të gjitha shtetet, kuptohet me ndryshime të pjesërishme.

Notimi gojor përfshin aktin e vlerësimit të dijeve të nxënësit nga arsimtari, gjatë përgjigjeve të nxënësit në pyetjet me gojë të mesuesit. Ky akt është më demokratik, sepse mundëson verifikimin e dijeve përpara një publiku, siç janë të gjithë nxënësit në klasë.

Notimi me shkrim ose testimi i nxënësve është një mënyrë e notimit që mundëson saktësinë pak më të madhe gjatë matjes së dijeve, duke pasur parasysh faktin se për të gjithë nxënësit vlejnë rregullat dhe kushtet e njëjta, pra atyre u jepen pyetje që janë të njëjta për të gjithë, po ashtu kanë kohë të njëjtë për zgjidhjen e detyrave të dhëna dhe i kanë kushtet e njëjta të mbledhjes së pikëve të fituara nga mësimdhënësit në lidhje me përgjigjet e dhëna nga ana e nxënësve.

Sfidat e cilësisë

Arsimi kudo në botë është njëra ndër fushat më komplekse dhe më të rëndësishme për përparimin e shoqërisë.

Në mënyrë që të përmbushen kërkesat shoqërore kërkon një kujdes të vazhdueshëm.

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka arsimi për kulturën dhe zhvillimin e shoqërisë, nuk mund të mos e shtrojmë çështjen e cilësisë që ofron, veçanërisht disa nga çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin e saj.

Shoqëria jonë ende nuk ka një situatë social-politike dhe ekonomike të qëndrueshme, megjithëse ka lëvizje dhe progres. Kjo pa qëndrueshmëri reflekton edhe në cilësinë e arsimit. Sigurimi i cilësisë mbetet sfidë e arsimit, për të cilën duhet të kontribuojnë të gjithë pjesëmarrësit, me dijet, vizionet dhe përpjekjet për ta rritur atë.

Ndryshimet në strukturën e shkollës, raporti midis ndryshimeve në shkollë dhe ndryshimit të shkollës nuk është dhe nuk mund të jetë njëjtë. Te ndryshimet në shkollë kemi të bejmë me njohjen, ndërkaq të ndryshimi i shkollës me aspektet teknike-estetike. Ndryshimi në fakt është jo vetëm njohje, por edhe vetënjohje.

Ndryshimet në shkollë janë një raport objektiv i anëve të brendshme dhe të jashtme, e formës dhe e përmbajtjes, e strukturës dhe e funksionit, e nxënësit që mëson dhe e edukatorit, e individit dhe e grupit që e zhvillohen në mënyrë harmonike njëra me tjetrën në drejtimin e përparimit, transformimit, përsosjes, bashkëkohësimit.

Këto kanë të bëjnë me ndryshimin e jetës sociale dhe pedagogjike në shkollë, favorizojnë progresin pedagogjik e social, u përgjigjen nevojave objektive të shkollës, nxënësit, arsimtarit, e bëjnë të mundur zgjerimin maksimal të shkollës, të lirisë së nxënësit dhe të arsimtarit, e bën të mundshëm kreativitetin e personalitetit.

Strategjia dhe modelet e mësimdhënies - ndryshimet shoqërore, ekonomike dhe politike kërkojnë ndryshime edhe në sistemin e arsimit dhe trajnimit me qëllim të rritjes së cilësisë të procesit edukativ-arsimor. Ndryshimet kanë të bëjnë me përcaktimin e aktiviteteve programore dhe strategjive, sipas nevojave dhe interesave të nxënësve dhe jo sipas dëshirës së edukatorit. Ai duhet të përdorë metoda të cilat në praktikë dihen si metoda aktive, që nxisin forcën kreative të nxënësve, të vendosë pratneritet të barabartë gjatë komunikimit me nxënësit, të stimulojnë vetëvlerësimin e punës së nxënësve, të diagnostifikojë problemin e më pas të planifikojë strategjitë.

Gjatë viteve të fundit ka filluar të zhvillohet mësimi me metoda të reja, të cilat janë më të preferuara tek nxënësit, ngase puna që e bëjnë me këtë model të mësimin ata mbeten më të kënaqur. Procesi i mësimin zhvillohet me një metodë të re që për nxënësit është me atraktive dhe mësojnë shumë nga njëri - tjetri gjatë punës së tyre në grupe.

Gjithnjë menaxhimin e ndryshimeve në shkollë duhet ta rishikojmë nga tri elemente bazë; sasinë e ndryshimit, kohëzgjatjen e ndryshimeve dhe natyrën e ndryshimit .

Ndryshimet bëhen për të ecur përpara, por ndryshimet nuk priten të japin rezultate menjëherë. Ato duan pak kohë që të vërehen. Sipas M.Fullan, ndryshimet në shkollë realizohen sipas një tempoje kohore.

Shkolla fillore mund të ndryshojë, sipas Fullanit, në afat prej tre vjetesh, shkolla e mesme në afatë prej gjashtë vjetesh, kurse një zonë shkollore duhet të ndryshojë në afat prej tetë vjetësh.

1.7 ARSIMI FAKTOR I NDRYSHIMIT

Dimensioni kohor është faktori kryesor që e përcakton dhe determinon fleksibilitetin e përmbajtjeve arsimore. Kjo ndërlidhje dhe varshmëri kohë-përmbajtje ka qenë dhe mbetet determinantë parësore, e cila e distancon arsimin nga kaluara dhe e bën me objektiv, më real, të afërt me jetën.

Komunikimi i arsimit me jetën e shpreh vizionaritetin e tij. Ai të bëhet urë në mes të tashmes dhe të ardhmes. Prandaj, nga konceptimi i strukturës dhe përmbajtjes së arsimit, varet sa do të jetë ai bashkëkohor dhe në funksion të kërkesave dhe nevojave që i shtron koha. Çdo tendencë që shkollës t'i imponohen vlera tradicionale të tejkaluara, nuk përkojnë me kërkesën që të rinjtë të përgatiten për ardhmëri, por për vlera të tejkaluara e kjo imponon nevojën që në koncipimin e përmbajtjeve arsimore të respektohet parimi: më afër të jetë e ardhmja se e kaluara.

Ligji Nr. 03/L-068

PËR ARSIMIN NË KOMUNATE REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka miratuar **Ligjin për arsimin në momunt e Republikës së Kosovës.**

Neni 1

Qëllimi i Ligjit

1.1 Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e arsimit publik në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë në komunat e Republikës së Kosovës.

1.2 Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të interpretohet si pakësim apo kufizim i të drejtave të cilat komunitetet dhe anëtarët e tyre i gëzojnë sipas ligjit në fuqi.

KREU I

Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Institucioneve të Republikës së Kosovës në Arsim

Neni 2

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Dhënia e kompetencave për komunat apo shkollat në fushën e arsimit sipas këtij ligji nuk mund të interpretohet si cenim i kompetencave të Kuvendit të Republikës së Kosovës ndër të tjera në lidhje me: a) çdo çështje që hyn në fushën e arsimit, e cila nuk është në interesin lokal;

b) formulimin e standardeve që i përkasin çështjeve që hyn në fushën e arsimit, pa marrë parasysh nëse çështja në fjalë influencon një çështje që është apo nuk është në interesin lokal.

Neni 3

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT) ka përgjegjësitë e mëposhtme: a) të zhvillojë politika dhe të hartojë e implementojë legjislacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë zhvillimin e arsimit të lartë dhe shkencën në Kosovë;

b) të promovojë një sistem arsimor jo-diskriminues në të cilin respektohet e drejta e secilit person për arsim dhe mundësitë e shkollimit cilësor të vihen në dispozicion për të gjithë;

c) të krijojë dhe menaxhojë një sistem të përgjithshëm të certifikimit për të gjithë mësimdhënësit në Kosovë;

d) të përhapë arsimin jo-formal dhe arsimin për të rritur në të gjitha nivelet, duke përfshirë zonat e thella dhe të promovojë mundësitë e shkollimit gjatë gjithë jetës për të gjithë;

e) të dizajnojë, implementojë dhe mbikëqyrë forma të barasvlershme dhe efikase të administrimit arsimor dhe menaxhimit shkollor;

f) të përmirësojë cilësinë, përshtatshmërinë dhe efikasitetin arsimor në të gjitha nivelet;

g) të lehtësojë zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor dhe ofrimin efikas të shërbimeve arsimore;

h) të promovojë hulumtimet në lidhje me zhvillimin social, ekonomik, shkencor, teknologjik dhe kulturor të Kosovës;

i) të zhvillojë një sistem gjithëpërfshirës të bibliotekave Universitare dhe shkollore;

j) të promovojë një politikë përfshirëse për integrimin e personave me dobësi dhe aftësi të kufizuara në sistemin arsimor; dhe

k) të promovojë pjesëmarrjen e prindërve dhe komunitetit në aktivitetet arsimore dhe format e duhura të partneriteteve shkollë-komunitet në nivelin lokal; l) inspektimin e Arsimit.

Përgjegjësitë dhe kompetencat e komunave në arsim

Neni 4

Kompetencat dhe kompetencat e zgjeruara të komunave

4.1 Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për atë që i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimitdhënësve dhe administratorëve.

4.2 Përveç kompetencave të referuara në Paragrafin 1 të këtij Neni, Komunave mund t'iu jepen kompetenca të zgjeruara në fushën e arsimit, ashtu siç përshkruhet nga ky ligj dhe ligjet e tjera në fuqi.

4.3 Në pajtim me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë me komuna të tjera dhe autoritete të tjera, brenda sferës të kompetencave të veta në fushën e arsimit. Kjo e drejtë përfshin bashkëpunimin me komunat dhe institucionet në Republikën e Serbisë, duke përfshirë agjensionet qeveritare.

Neni 5

Kompetencat e Komunave në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të Arsimit Publik (Parashkollor, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë)

Kompetencat e referuara në Nenin 4 të këtij ligji përfshijnë kompetencat e mëposhtme të veçanta komunale në arsimin publik për nivelet 0 (parashkollor), 1 (fillor), 2 (të mesëm të ulët) dhe 3 (të mesëm të lartë) në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT-i:

a) ndërtimin e objekteve shkollore në pajtueshmëri me Kapitullin 3 të këtij ligji dhe me ligjet e tjera në fuqi;

b) regjistrimin dhe pranimin e nxënësve në pajtim dhe me respektimin e parimeve të mosdiskriminimit sipas ligjit;

c) punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhjes dhe punësimit të të punësuarve publikë;

d) zgjedhjen e Drejtorit dhe/ose Zëvendës Drejtorit të institucioneve edukativo- arsimore në pajtim me procedurat ligjore për rekrutimin dhe kriteret ligjore të përcaktuara nga MASHT-i nga një komision i caktuar nga Kuvendi Komunal në të cilin dy anëtarë do të jenë nga Komuna dhe një nga MASHTI-i;

e) regjistrimin, inspektimin e shëndetit publik dhe sigurisë dhe licencimin e institucioneve arsimore parashkollore, në pajtim me Kapitullin 4 të këtij ligji; f) pagesën e stafit menaxherial, si dhe të personelit tjetër të punësuar në pajtim me legjislacionin e Kosovës;

g) trajnimin e edukatorëve dhe stafit tjetër profesional në pajtim me udhëzimet, parimet dhe standardet e shpallura nga MASHT-i;

h) mbikëqyrjen e procesit arsimor në pajtim me udhëzimet e përcaktuara nga MASHT-i; 4

i) përgatitjen, miratimin dhe implementimin e Rregullores së Punës për shkollat, duke përfshirë Kodin e Mirësjelljes për stafin menaxherial, mësimdhënësit, personelin tjetër dhe nxënësit, si dhe masat disiplinore;

j) raportimin te qeveritë lokale dhe MASHT-i rreth arsimit, veprimtarive buxhetore dhe menaxhuese për nivelin parashkollor në pajtim me legjislacionin komunal dhe qendror;

k) aplikimin e këtyre funksioneve apo kompetencave të deleguara, ashtu si përcaktohet nga marrëveshja formale mes komunës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës;

l) monitorimin dhe raportimin tek prindërit apo autoritetet e tjera përgjegjëse të vijueshmërisë arsimore dhe sociale të nxënësve, ashtu si përcaktohet nga legjislacioni; dhe

m) caktimin e shumave të participimit të prindërve për pranimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte në pajtim me ligjet e Kosovës.

Neni 6

Përgjegjësitë administrative të Komunave

Kompetencat e referuara në Nenin 4 të këtij ligji përfshijnë përgjegjësitë e mëposhtme komunale administrative në arsimin publik në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT-i:

a) komunat ofrojnë shërbime arsimore administrative të mjaftueshme për funksionet e arsimit parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë në pajtim me ligjin;

b) shërbimet arsimore administrative minimale përfshijnë emërimin e Drejtorit Komunal për departamentin/drejtoratin, i cili përbëhet nga sektori funksional për arsimin si dhe personel mbështetës të mjaftueshëm profesional për të kryer detyra e kërkuara sipas legjislacionit të Kosovës; dhe

c) monitorimi dhe raportimi i menaxhimit dhe veprimtarive arsimore në komuna kryhen nëpërmjet organit administrativ komunal të identifikuar si kompetent për atë funksion nga Kryetari i Komunës.

KREU III

Kompetencat në Ndërtimin e Objekteve Arsimore Publike

Neni 7

Kompetencat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Kompetencat e MASHT-it në ndërtimin e objekteve shkollore përfshijnë ofrimin e asistencës teknike për komunat në planifikimin dhe projektimin e objekteve arsimore nëse kërkohet; shqyrtimin e të gjitha planeve dhe projekteve për pajtueshmëri me standardet e projektimit dhe ndërtimit të shkollave në Kosovë para fillimit të prokurimeve për shërbimet e ndërtimit; financimin dhe miratimet e ndërtimeve që financohen nga grantet e drejtpërdrejta të MASHT- 5 it; dhe inspektimet para vënies në përdorim të objekteve të ndërtuara për pajtueshmëri me planet e miratuara dhe krijimin e kushteve normale për procesin arsimor dhe trajnues.

Neni 8

Kompetencat e Komunave

8.1 Objektet arsimore publike mund të ndërtohen nga komuna dhe të financohen nga buxhetit të komunës dhe donacionet tjera.

8.2 Kompetencat komunale në ndërtimin e objekteve arsimore përfshijnë identifikimin e nevojave për ndërtimin e objekteve arsimore, përcaktimin e vendndodhjes së objekteve dhe

ofrimin e tokës komunale, përgatitjen e planit të implementimit, projektimin e objektit, dhënien e lejes së ndërtimit, prokurimin e shërbimeve dhe materialeve të ndërtimit, inspektimet e nevojshme, dhënien e lejeve përfundimtare për vënie në përdorim të objektit dhe krijimin e kushteve normale për procesin e arsimimit dhe trajnimit.

8.3 Komuna duhet të paraqesë konfirmimin për disponueshmërinë e tokës komunale për ndërtim, planin e implementimit të projektit dhe projektin përfundimtar të shkollës jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës së planifikuar për fillimin e prokurimit për shërbimet e ndërtimit.

8.4 Shkollat do të kenë buxhetin e tyre të ndare nga Komuna.

Neni 9

Kompetencat që përcaktohen nga Burimet e Financimit

9.1 Nëse i gjithë financimi apo një pjesë e financimit të një objekti është grant i drejtpërdrejtë nga MASHT-i dhe granti është i pranuar formalisht nga komuna për atë ndërtim:

a) projekti i ndërtimit duhet të shqyrtohet dhe miratohet apo refuzohet nga MASHT-i Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga momenti i dorëzimit nga komuna dhe para fillimit të prokurimit për punimet e ndërtimit;

b) shqyrtimi dhe miratimi i këtyre projekteve nga MASHT-i është transparent dhe i bazuar në pajtueshmërinë me Master Planin e Ndërtimit Arsimor apo ndonjë ligj pasues dhe përmbushjes së kriterëve të MASHT-it për dizajnin dhe ndërtimin e shkollave; dhe

c) procesi i shqyrtimit dhe miratimit nga ana e MASHT-it rishikohet në pajtim me legjislacionin e Kosovës.

9.2 Nëse asnjë grant i drejtpërdrejtë nga MASHT-i nuk përdoret për të financuar të gjitha kostot apo një pjesë të kostove të ndërtimit për objektin arsimor, MASHT-i mund vetëm të miratojë projektin dhe ndërtimin, në pajtim me kriteret zyrtare të MASHT-it për dizajnin dhe ndërtimin e shkollave.

KREU IV

Licencimi dhe Regjistrimi i Mësimdhënësve dhe Licencimi i institucioneve

Neni 10

Licencimi , Regjistrimi dhe Punësimi i Mësimdhënësve

10.1 Mësimdhënësit mund të regjistrohen dhe punësohen vetëm nëse ata plotësojnë kriteret dhe standardet arsimore të caktuara me ligj.

10.2 MASHT-i organizon proces të para regjistrimit në shkallë vendi, duke u bazuar në kritere të drejta dhe transparente për të krijuar listën e mësimdhënësve të licencuar të mësimdhënësve të ardhshëm, kjo listë azhurnohet për çdo vit.

10.3 Të gjithë mësimdhënësit e ardhshëm të cilët janë të para regjistruar licencohen nga MASHT-i.

10.4 Pas krijimit të procesit të para regjistrimit dhe licencimit në shkallë vendi, dhe pas publikimit të listë së pare të hapur, komunat mund të regjistrojnë dhe punësojnë vetëm kandidatët, të cilët janë të përfshirë në listën e caktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

10.5 Procesi i licencimit i përcaktuar në këtë nen, i kushton vëmendje të veçantë nevojave të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në Kosovë, përfshirë edhe mundësinë efektive për dërgimin e mësimdhënësve nga shtetet e huaja.

Neni 11

Licencimi i Arsimit

11.1 Të gjitha institucionet arsimore në Kosovë licencohen në pajtim me kriteret dhe standardet e caktuara me ligj. Institucionet publike arsimore licencohen nga komuna para fillimit të funksionimit të tyre.

11.2 Komunat lëshojnë licenca të biznesit vetëm për institucionet arsimore private në mënyr te njëjtë sikur licencat tjera të biznesit sipas dispozitave të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal të Kosovës. Komunat para lëshimit të licencës për biznes për objektet

edukativoarsimore private në territorin e tyre kërkojnë dokumente që dëshmojnë regjistrimin dhe licencimin nga MASHT-i si institucion edukativo-arsimor.

11.3 Komunitat pas marrjes së një vendimi me shkrim nga ana e MASHT-it lëshojnë vendime administrative të cilat japin, mohojnë apo anulojnë licencimin e çdo institucioni edukativoarsimor publik.

a) MASHT-i e dorëzon njoftimin për mendimin e tij tek komuna dhe institucioni që e ka bërë kërkesën brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas dorëzimit të kërkesës për mendim nga komuna.

b) Komuna informon institucionin që e ka bërë kërkesën për vendimin e saj jo më vonë se 60 ditë pasi ta pranojë pranon mendimin nga ana e MASHT-it. 7

11.4 Në të gjitha rastet kur vendimi i komunës dallon nga mendimi i MASHT-it, komuna duhet t'i ofroj MASHT-it dhe institucionit që e ka bërë kërkesën sqarim të hollësishëm me shkrim për arsyet e vendimit të saj; dhe

11.5 Nëse komuna nuk e informon institucionin që e ka bërë kërkesën brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, siç kërkohet në paragrafin 3 b të këtij neni, mendimi i MASHT-it vlerësohet të jetë vendim përfundimtar për licencimin e Institucionit edukativo-arsimor.

KREU V

Arsimimi në Gjuhën Serbe

Neni 12

12.1 Komunitat kanë kompetenca për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve edukativoarsimore në gjuhën serbe.

12.2 Shkollat të cilat japin mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan programe apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

12.3 Plan programet apo tekstet shkollore përkatëse të Republikës së Serbisë nuk do të përdoren për mësimdhënie para njoftimit të MASHT-it; nëse pas këtij njoftimi, MASHT-i brenda tre muajve nuk paraqet ndonjë kundërshtim (në mënyrë që t'i ofrohet kohë e mjaftueshme Ministrisë të shqyrtoj plane programet apo tekstet shkollore në fjalë), ai material mund të përdoret

12.4 Në rast të paraqitjes së kundërshtimit nga ana e MASHT-it për përdorimin e ndonjë plan programi apo teksti shkollor të caktuar në gjuhën serbe, çështja i dërgohet komisionit të pavarur, i cili themelohet në bazë të nenit 13 të këtij ligji, për të shqyrtuar plan programin apo librin shkollor në fjalë, për të siguruar përputhshmërinë e tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi. Plan programi mësimor i caktuar ose teksti shkollor nuk mund të përdoren për mësimdhënie pa vendosur komisioni i pavarur.

Neni 13

Komisioni i Pavarur

13.1 Komisioni i pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe përbëhet nga shtatë (7) anëtarë: a) tre (3) përfaqësues nga MASHT-i; b) tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga kuvendi i Republikës së Kosovës, të cilët që mbajnë ulëset e rezervuara apo garantuara për komunitetin serb të Kosovës; dhe c) një (1) anëtar ndërkombëtar, i zgjedhur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe përfaqëson atë.

13.2 Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash..

13.3 Kryesimi i Komisionit bëhet përmes rotacionit në mes të përfaqësuesit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe përfaqësuesit të zgjedhur nga MASHT-i çdo vit.

Neni 14

Kompetencat e Zgjeruara të Komunës së Mitrovicës Veriore Kompetencat e poshtëshënuara janë kompetencat komunale për arsimin e lartë në Mitrovicën Veriore:

- a) Universiteti i Mitrovicës Veriore është institucion publik autonom i arsimit të lartë;
- b) Universiteti miraton statutin që saktëson organizimin dhe qeverisjen e brendshëm të tij si dhe procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike, në pajtim me legjislacionin kornizë qendror të Republikës së Kosovës, i cili do të shqyrtohet nga një komision i pavarur:
 - (i) komisioni i pavarur përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve:
 - (ii) tre (3) përfaqësues të përzgjedhur nga MASHT-i;
 - (iii) tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga universiteti; dhe

(iv) një (1) anëtar ndërkombëtar, i përzgjedhur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, i cili e përfaqëson edhe atë.

(v) komisioni i merr vendimet me shumicë votash;

(vi) kryesimi i komisionit bëhet përmes rotacionit në mes të përfaqësuesit të zgjedhur nga Universiteti dhe një përfaqësues i përzgjedhur nga MASHT-i.

c) Vendimet për pajtueshmërinë e statutit me legjislacionin kornizë qendror, standardet dhe praktikat më të mira evropiane si dhe për çështjet që kanë të bëjnë me akreditimin e universitetit Brenda sistemit universitar të Kosovës merren nga komisioni i pavarur i themeluar sipas nenit 14b të këtij ligji;

d) Komuna e Mitrovicës Veriore ka kompetencat për këtë universitetin publik në gjuhën serbe, në pajtim me ligjin në fuqi të Republikës së Kosovës;

e) Universiteti do të ketë Bordin e përbërë nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy do të caktohen nga komuna dhe pesë (5) do të zgjidhen nga fakulteti apo nga organi i studentëve të Universitetit dhe dy (2) anëtarët tjerë do të zgjidhen në mënyrën e përcaktuar në statutin e Universitetit;

f) Komuna gjithashtu do të sigurojë që Universiteti të ketë objekte dhe financim adekuat për veprimtarinë e tij nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe burimet e tjera institucionale. Fondet për universitetin nga Republika e Serbisë duhet të jenë transparente dhe të bëhen publike, në pajtim me ligjet e Kosovës;

g) Veprimet dhe burimet buxhetore që i ofrohen Universitetit të Mitrovicës Veriore duhet të jenë në pajtim me ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në legjislacionin që hyn në fuqi deri më 1 janar 2009; dhe 9 h) Komuna e Mitrovicës Veriore mund të bashkëpunojë me çdo komunë tjetër për drejtimin e universitetit.

KREU VI

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare dhe Hyrja në Fuqi

Neni 15

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

15.1 Institucionet e qeverisjes lokale harmonizojnë Statutet dhe Rregulloret e aplikueshme me dispozitat e këtij ligji Brenda 6 (gjashtë) muajsh nga hyrja e tij në fuqi.

15.2 Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, zhvlehtësohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë Ligj.

Neni 16

Mjetet Juridike Kundër çdo veprimi apo mosveprimi të ndërmarr nga ndonjë autoritet sipas këtij ligji pala e interesuar ka te drejte ankese ne procedurën administrative apo gjyqësore.

Neni 17

Hyrja në Fuqi Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në qoftë se përmbajtjet arsimore janë tradicionale nuk mund të krijojnë perspektive për njeriun. Kjo ka rëndësi ,për vetë faktin se koncipimi I përmbajtjeve arsimore është akt vizionar, supozon njeriun në kushtet e reja.

Sipas mendimit tim kjo është koha reale edhe për arsyet së paraqet periudhë relativisht të gjatë ,që mund ti supozojmë komplekset zhvillimore, sistemin e vlerave dhe modelet teorike të përmbajtjeve arsimore, të cilat në mes vete duhet të jenë konsistente.

Menaxhime me ndryshime në arsimin prauniversitar në Kosovë

Në kuptimin e udhëheqjes dhe menaxhimit të sistemit arsimor në periudhën e pasluftës që karakterizohet nga: motivimi i lartë i administratës dhe udhëheqjes vendore arsimore për të përmirësuar performancën e sistemit arsimor dhe për nga prania e një numri të madhë të eksperteve e administratorëve ndërkombëtare të arsimit si në kuadër të strukturave të UNMIK-ut, ashtu edhe në organizatat e shumta joqeveritare ndërkombëtare, të angazhuara aso kohe në programe të ndryshme të mbështetjes së arsimit kosovar.

Motivimi i lartë i udhëheqjes dhe i administratës vendore kishte bërë që programet e ndryshme aftësuese të hasin në hapësir dhe receptivitet të theksuar të zyrtarëve e të administratorëve të cilët aftësoheshin në këto programe. Kjo e kishte ngritur dukshëm efektivitetin e programeve trajnuese, por kishte pasur ndikim edhe në ngritjen e efikasitetit të menaxhimit të institucioneve arsimore dhe të drejtimit të sistemit në përgjithësi. Programet aftësuese të udhëheqjes arsimore ishin organizuar ose dhe bashkërenditur fillimisht nga Projekti Kanadez për Aftësimin e Mësimdhënësve Kosovare (KEDP), e cila deri në vitin 2004 ka funksionuar edhe si agjenci udhëheqëse në fushën e aftësimeve.

Prej vitit 2000 deri në vitin 2005, rreth 700 udhëheqës arsimore kishin kaluar nëpër ndonjë formë të aftësimit të udhëheqjes arsimore në nivele të ndryshme të administratës, të institucioneve dhe të sistemit. Si do të shihet me vonë, këtyre programeve u mungonte

qëndrueshmëria institucionale dhe thellësia e trajtimit të problemeve të udhëheqjes, por, megjithatë, këto kishin luajtur rol të pazëvendësueshëm në sigurimin e shërbimeve themelore arsimore në fillim (1999 - 2001 faza emergjente) dhe në ngritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve në fazën e konsolidimit të sistemit (2002 - 2005). Një karakteristike tjetër e kësaj periudhe ishte shkëmbimi i drejtëerdrejtë i përvojave të udhëheqjes arsimore ndërmjet zyrtareve të shumtë ndërkombëtare dhe të atyre vendore.

Ky aftësim i gjalle dhe pa shkeputje nga puna kishte ndodhur në të gjitha nivelet e administrates e të udhëheqjes arsimore me efekt të drejtpërdrejtë në cilësinë e udhëheqjes e të menaxhimit. Vetëm në administratën qendrore të MASHT-it, në vitin 2002, ishin të angazhuar me se 30 zyrtarë, eksperte e keshilltare nderkombetare. Për ilustrim, në atë kohë administrata qendrore e MASHT-it kishte 50 zyrtarë vendorë. Të tjerë ekspertë ishin të angazhuar në nivel rajonal, në organizata të ndryshme joqeveritare dhe në projekte të tjera mbështetëse qeveritare, të cilët realizonin bashkëpunim të përditshëm me udhëheqjen arsimore kosovare në të gjitha nivelet. Në mënyrë graduale dhe paralelisht me ngritjen e aftësive menaxhuese e udhëheqëse të udhëheqjes vendore.

2.1.- Arsimi parauniversitar në Kosovë

Gjendja e tanishme

Ndodhte edhe bartja e autorizimeve dhe e kompetencave nga zyrtaret e UNMIK- ut e nga agjenci udhëheqëse tek zyrtarët vendore. Ky ishte një proces i kontrolluar i transferimit të kompetencave dhe i ngritjes e i zhvillimit të kapaciteteve për qeverisje në sistemin arsimor kosovar. Si rezultat i këtij procesi kishte një demokratizim të udhëheqjes arsimore, u shënuan ndryshime pozitive në vetë sistemin dhe u përmirësuan e u humanizuan deri diku ambienti dhe kushtet e punës. Një prej efekteve të këtij demokratizimi ishin edhe nisma të ndryshme për përmirësimin e menaxhimit, përfshirja me e madhe e palëve të interesuara ne udhëheqjen e shkollës (të përfshira edhe në legjislacionin në fuqi) si dhe, përfundimisht, ngritja relative e cilësisë së shërbimeve arsimore.

Ndër segmentet e udhëheqjes arsimore në të cilat ishte punuar mjaft, por që mbetej të bëhej edhe më, ishin: institucionalizimi i programeve aftësuese të udhëheqjes arsimore, ristrukturimi dhe zhvillimi i personelit të administratës qendrore të MASHT- përfshirja më e gjerë e palëve të interesuara, sigurimi i informatave më relevante dhe më të krahasueshme

në lidhje me popullacionin e sistemit arsimor, si dhe profilizimi dhe ndarja e funksioneve administrative nga ato profesionale në nivel të administratës qendrore të MASHT-it.

Mungesa e institucioneve dhe e programeve të qëndrueshme për aftësim të administratës arsimore, mungesa e ofruesve të pavarur të shërbimeve aftësuese, sensibilizimi i pamjaftueshëm i komunitetit, mungesa e informatave dhe e analizave për nevoja aftësuese dhe centralizimi i tepruar i sistemit ishin konstatuar aspekte të qeverisjes, si rrjedhojë e të cilave kishte politizim relativ të arsimit, kufizim të autonomisë së shkollës, ndikim tek udhëheqja tradicionale e institucioneve arsimore dhe tek përfshirja e pamjaftueshme e komunitetit në çështjet e shkollës. Përfundimisht, këto kishin shkaktuar vështirësi në udhëheqjen e në menaxhimin e institucioneve arsimore (pavarësisht nga konstatimi se procesi kishte ngritje dhe zhvillim gradual në pjesën e arritjeve të analizës).

Kjo cilësi e udhëheqjes dhe e menaxhimit kishte sjellë lëshime të konsiderueshme gjatë punësimit të personelit, mosshfrytëzim të duhur të resurseve njerëzore, mungesë të monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit, si dhe mungesë të të dhënave të besueshme për sistemin e arsimit. Të gjitha këto, bashkë me përcjelljen joadekuate të nxënësve pas largimit nga institucioni i tyre arsimor, dukej të kishin qenë ndër arsytet për cilësi të pakënaqshme të shërbimeve arsimore. Shqyrtimi i arritjeve tregoi se “ishin krijuar parakushtet për një proces të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve për qeverisje dhe udhëheqje”, ndërsa shqyrtimi i dobësive sinjalizoi për cilsi “të pakënaqshme të udhëheqjes dhe qeverisjes arsimore”. Bazamenti për trajtim dhe tejkalim të dobësive u krijua duke ndërtuar mbi praktikatat e mira të arritjeve dhe duke propozuar masa konkrete për arritjen e objektivave të përcaktuara.

- gjithnjë në suaza të vizionit dhe të misionit të definuar bashkërisht të sistemit arsimor të Kosovës.

2.2. Standardet e drejtuesit të shkollës - menaxhimit

Në hartimin e standardeve të drejtorit të shkollës janë marrë parasysh disa momente të rëndësishme, si përvoja e krijuar për hartimin e standardeve në fusha të tjera të reformës arsimore, veçanërisht të atyre të mësuesit në arsimin parauniversitar, boshllëku i madh në fushën e drejtimit dhe administrimit të shkollës, konsolidimi i mendimit se nëpërmjet standardeve sigurohet rruga më e mirë për përmirësimin e fushave të ndryshme që lidhen me drejtimin e shkollës, (si licencimi, programet e formimit dhe vlerësimi i nxënësve etj).

Në mënyrë që standardet t'i shërbejnë perspektivave të reja mbi drejtimin e shkollës, metodologjia e hartimit të tyre u fokusua në dy drejtime:

- në njohjen dhe studimin e varësive ndërmjet drejtimit të shkollës dhe rezultateve të saj, e veçanërisht në lidhje me arritjet e nxënësve.
- në studimin e tendencave të pranishme në shoqërinë e sotme dhe në arsim, të cilat lidhen me pikëpamjet mbi drejtimin e shkollës.

Drejtimi efektv i shkollës

Synimi kryesor i drejtuesit të shkollës është që të sigurojë drejtim dhe menaxhim profesional, me synim rritjen e përmirësimit dhe suksesit për shkollën. Drejtuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi edukativ, nxitës, motivues e produktiv për stafin dhe të gjithë nxënësit.

Drejtuuesi është udhëheqësi profesional në shkollë dhe bashkë me të gjitha institucionet që veprojnë në shkollë është përgjegjës për krijimin e vizionit, përmbushjen e misionit dhe vendosjen e një drejtimi strategjik për shkollën. Interpretimin korrekt të legjislacionit aktual shkollor, menaxhimin e ndryshimit dhe planifikimin për të ardhmën e shkollës.

Sigurimin e suksesit dhe përmirësimit të shkollës nëpërmjet vetëvlerësimit.

Sigurimit të cilësisë së lartë në mësimdhënie, e në të nxënësit të të gjithë nxënësve, garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë, sigurimin e përkrahjes së komunitetit të gjerë të shkollës, zhvillimin e vetë profesional dhe të të gjithë stafit të shkollës.

Qëllimi i standardeve të drejtuesve të shkollës

Qëllimi i standardeve të drejtuesit të shkollës është të përcaktojnë komponentët e përgjegjësisë dhe të specifikojnë pritshmëri nga të gjithë aktorët e shkollës, informojnë dhe nxisin drejtuesit në shërbim dhe ata që aspirojnë të jenë të tillë të sigurojnë një mjet për përdorim nga drejtuesit në punën e përditshme dhe ato që punojnë me to, të sigurojnë një platformë për zhvillim profesional dhe veprime konkrete.

2.3. Cilësia dhe efektiviteti

Së bashku me tërë shoqërinë kosovare, sistemi arsimor i Kosovës ka kaluar nëpër procese intensive transformuese nga gjendja emergjente e pasluftës deri në fazën konsoliduese zhvillimore të dhjetë viteve të fundit. Pas masave të domosdoshme në fushën e legjislativës dhe të infrastrukturës gjatë fazës emergjente, realitetet e reja të krijuara në shoqërinë kosovare u përcollën edhe me masa me tipike “softuerike” në sektorin e arsimit, të cilat me kalimin e kohës do të siguronin cilësi dhe efektivitet më të lartë të shërbimeve arsimore.

Gatishmeria për ndryshime në radhët e komunitetit arsimor në Prizren përbënte një sfond të domosdoshëm konstruktiv dhe garanci për sukses të masave të reja. Masat e para u ndërmorën për të vendosur shtyllat kryesore mbi të cilat do të zhvilloheshin veprimet e ardhshme reformuese në sistemin arsimor kosovar. Për këtë qëllim, me mbështetjen e UNICEF-it filloi puna për hartimin e Komizës së Re Kurrikulare të Kosovës, filloi zbatimimi i programeve intensive të aftësisë të mësimdhënësve dhe u vendos struktura e arsimit parauniversitar në Kosovë.

Me një prapavështrim dhjetëvjeçar mund të konstatojmë se vitet e para të ringjalljes së arsimit kosovar përqendroheshin rreth reformës kurrikulare, përfshirë metodat e mësimdhënies, përmbajtjen e programeve, tekstet shkollore, vlerësimin e nxënësve dhe filozofinë e qasjeve të reja në arsim.



Shkolla inkluzive, pilotimi i qasjeve të reja, mësimi me nxënësin në qendër, projekti "Shkolla mike e fëmijës", projekte të shumta për kyçjen e komunitetit në qeverisje dhe në përkrahje të shkollës, projekte për demokratizimin e raporteve të faktorëve arsimor,

metodat e reja dhe të shumëllojshme për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe shprehive të nxënësve etj., ishin vetëm disa nga 'risitë' e shumta në zbatim, që pothuajse kishin vërshuar shkollat tona gjatë dy-tri viteve të para të pasluftës. Me gjithë mungesën e një qasjeje të planifikuar e më sistematike në zbatimin e këtyre risive, prapëseprapë, gjeja e parë që bie në sy gjatë vizitave në shkollat tona është fryma e re me renditje të re të bankave, raporte më të lira mësimdhënës - nxënës, vlerësimi i shumëllojshëm, vetëdija e shtuar për të drejtat e fëmijëve e të tjera.

Në fund, vërehet se planprogramet e reja (për arsimin e përgjithshëm dhe për arsimin profesional), tekstet e reja shkollore, metodat e reja të mësimdhënies dhe mënyrat e reja të vlerësimit kanë ndikuar në ngritjen e cilësisë së shërbimeve arsimore dhe të efektivitetit të sistemit arsimor.

Megjithatë, ekspertët kanë vërejtur se edhe më shumë mundet dhe duhet të bëhet në segmente të ndryshme të realitetit arsimor në Kosovë.

Ata konstatuan mungesën e mekanizmave dhe institucioneve përkatëse për akreditim, për sigurim të cilësisë, për vendosjen e standardeve dhe për vlerësim të jashtëm; po ashtu u theksua mungesa e një Këshilli Kombëtar funksional për planprograme dhe tekste shkollore, mungesa e kapaciteteve për hulumtime në arsim, si dhe mungesa e politikave afirmative për hartimin, botimin dhe shpërdarjen e teksteve dhe mjeteve shkollore. Të gjitha këto dhe rrethana të tjera, si mungesa e kapaciteteve të duhura njerëzore dhe jostabiliteti shoqëror e ekonomik, kishin shkaktuar mosfunksionim të duhur të sistemit për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë, planprograme të ngarkuara shkollore me mangësi të theksuara sa i përket ndërmarrësisë dhe me përqendrim në dije në vend të sigurimit të shkathtësive, të cilat paraqesin edhe rrëshqitje nga Komiza e Kurrikulit të Ri të Kosovës. Pos kësaj, ka probleme lidhur me përcaktimin e nocionit të shkathtësive bazë (prezantuese apo ndërpersonale, individuale apo shoqërore, teknike apo profesionale, në formë të vetëdijes artistike e kulturore e të tjera).

Natyrisht, pamundësia e një përkufizimi të tillë ka ndikuar edhe në moszbatimin e tyre në planprogramet e zhvilluara mësimore.

Ndërkaq, sa u përket teksteve shkollore dhe mjeteve të tjera didaktike u theksua mungesa e burimeve alternative të informacionit, mungesa e teksteve të arsimit profesional, mungesa e literaturës dhe teksteve në lënde të caktuara dhe mungesa relative e cilësisë së teksteve të punuara në bazë të planprogrameve të reja.

Si rezultat i të gjitha këtyre, pa marrë para sysh sukseset relative, kemi një situatë me cilësi të pakënaqshme të shërbimeve arsimore.

Kjo situatë kërkon hartimin e politikave, strategjive dhe ndërtimin e mekanizmave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe të efektivitetit të sistemit. Në këtë kuptim, u theksua nevoja e përqendrimit në aftësimin e mësimitdhënësve, në vendosjen dhe zbatimin e standardeve kombëtare, në avancimin e metodave të vlerësimit dhe në përmirësimin e kontekstit arsimor - të gjendjes materiale dhe të infrastrukturës fizike gjithnjë me qëllim përfundimtar përmirësimin e cilësisë së përgjithshme.

Sistemi arsimor domosdo duhet t'i përshtatet ndryshimeve dhe nevojave bashkëkohore, por dihet gjithësesi se pa zhvillimin përkatës të arsimit dhe shkollave, si dhe të mirave njerëzore, nuk ka as edhe zhvillim përkatës ekonomik-shoqëror. Në ndryshime të tilla bëjnë pjesë ndryshimet teknologjike në bazë të cilës mbështeten zhvillimi i teknologjive informative dhe komunikuese që njëherit edhe transformojnë jetën ekonomike - shoqërore.

Veprimtaria edukative - arsimore, patjetër të zhvillohet dhe të hapëroje me kohën, me ç'rast me kujdes duhet të ndryshohen programet mësimore, përkryhet puna organizative, kadrovike dhe teknike.

2.4. Kapacitetet menaxhuese të sistemit

Sistemi kosovar i arsimit doli nga periudha e izolimit të gjatë dhe nga lufta e fundit të viteve të nëntëdhjeta, pothuajse tërësisht e shkatërruar, si nga aspekti i infrastrukturës fizike, ashtu edhe për nga kapacitetet dhe resurset njerëzore. Menaxhimi i arsimit vijon të reformohet në funksion të krijimit të kulturës së re të nxënies. Në vijim, analizohen disa aspekte kryesore të procesit reformues, që në tërësinë e tyre na japin pjesën tjetër të pikturës së përgjithshme të reformës tonë arsimore. Do ta vlerësojmë argumentin në funksion të kushteve që po krijojnë ndryshimet e reja për reformën e nxënies dhe sfidat që do duhen përballuar.

Reforma po e riorganizon menaxhimin e arsimit në tri aspekte kryesore: Shndërrimi i strukturës administrative po arrihet nëpërmjet:

- zhvillimit të sistemit të menaxhimit shkollor,
- shpërndarjes së kompetencave sipas niveleve (devoluimi)
- rolit të ri të qeverisjes vendore,

- harmonizimit të lidhjeve mes organeve konsultative, vendimmarrëse dhe ekzekutive. Reforma i kushton vëmendje procesit të decentralizimit arsimor, duke konsideruar parimet vijuese:

- sigurimi i arritjeve të larta, transparence dhe efikasitet administrativ,
- kultura e matjes,
- menaxhim mbi bazën e arritjeve,
- role të reja për drejtorët e shkollave.

Në terma më konkret, disa nga aspektet, që lidhen me procesin e tjetërsimit të autonomisë shkollore, në funksion të përmirësimit të cilësisë së arritjeve të nxënësve, rezultojnë të jenë:

- Zhvillimi i politikave efikase për vetemenaxhimin e shkollës.
 - Rritja e aftësisë së shkollës për të vetëvepruar e që lidhet me fuqizimin e kapaciteteve që u përkasin sferave kurrikulare dhe atyre administrative-menaxhuese. Orientimi i vendimmarrjes nga standardet dhe treguesit arsimor sasior dhe cilësor. Kalimi drejtë autonomisë shkollore po kërkon plotësimin e kushteve, sikundër ndihmon përdorimi i standardeve dhe treguesve për vlerësimin e cilësisë së arritjeve dhe të efikasitetit arsimor. Kultivimi i kulturës për ta bazuar vendimmarrjen, jo mbi opinionet, por mbi të dhënat, treguesit dhe standardet, si kusht themelor për kalimin drejt autonomisë shkollore, rezulton të jetë një sfidë, përballja e të cilës kërkon angazhim profesional dhe pilotim.
- Krijimi i kapaciteteve për të përgatitur dhe menaxhuar planet operative dhe zhvillimore të shkollës. Me gjithë përpjekjet e MASHT-it dhe të agjencive të saj vartëse, konstatohet se ende nuk kemi drejtues shkollash profesionistë me kompetenca të mira planifikuese, që do të siguronte planifikimin afatmesëm dhe atë vjetor të shkollës. Në kushtet e shkollës autonome ky kapacitet i munguar ndikon drejtpërdrejt mbi cilësinë e shërbimeve arsimore që ofron shkolla. Ndaj merr rëndësi qartësimi dhe përmirësimi i kompetencave për planifikimin e burimeve nga lidhshipi i shkollës.

2.5. Parimi i efikasitetit dhe i efektivitetit

Ekzistenca e një sistemi funksional nuk qëndron në përshtatjen e sistemit, gjendjes reale, por në zhvillimet sasiore e cilësore, si të sistemit në tërësi, ashtu edhe të pjesëve të cilat e përbëjnë atë tërësi. Ky parim kërkon që të krijohen mekanizma dhe politika të tilla zhvillimore, të cilat garantojnë zhvillim të pandërprerë sasior e cilësor të sistemit.

Që sistemi i arsimit të jetë efikas, ai duhet të prodhojë rezultate maksimale me shpenzime më të vogla të mundshme njerëzore, kohore, financiare e materiale. Ky parim kërkon që të krijohen mekanizma funksional për përcjelljen, matjen dhe vlerësimin sistematik të investimeve në arsim, të monitorohen mënyrat e alokimit të mjeteve, shfrytëzimi racional i burimeve të reja, hyrja në sistem, si dhe dalja nga sistemi i arsimit, procesi i qarkullimit të hyrjeve dhe të daljeve nga sistemi i arsimit.

Aspekti tjetër i këtij parimi është efektiviteti. Me efektivitet nënkuptohet jo sasia e arritjeve, por dobia e përfitimit që kanë qytetarët e Kosovës dhe shoqëria kosovare nga arritjet në arsim. Arsimi është efektiv, atëherë kur ai ju sjell të mira të gjithë qytetarëve të Kosovës. Deri sa efikasiteti përcaktohet përmes analizave që bëhen, duke vlerësuar sasinë e rezultateve të arritura dhe të burimeve të shpenzuara për arritjen e rezultateve maksimale, efektiviteti ka të bëjë me sigurimin e dobive sa më të mëdha me mjetet e dhëna.

Parimi i efikasitetit dhe i efektivitet duhet të sigurojë zhvillim maksimal të burimeve njerëzore, i cili sipas analizave të OECD-së, paraqet fitimin që buron nga arsimi, i cili mund të shprehet me të ardhura më të mëdha, me shkallë më të lartë të punësimit, me lidhje më të fuqishme me tregun e punës, me shëndetin publik më të mirë dhe me një varg tjetër të përfitimeve jovalutore.

Reformat në shkolla

Jetojmë në një kohë që karakterizohet me ndryshime të thella dhe rrënjesore. Këto ndryshime paraqesin një sfidë të madhe për të gjitha segmentet e shoqërisë, në veçanti për sistemin arsimor. Sistemi arsimor domosdo duhet t'iu përshtatet ndryshimeve dhe nevojave bashkëkohore, por dihet gjithësesi se pa zhvillimin përkatës të arsimit dhe shkollave, si dhe të mirave njerëzore, nuk ka as edhe zhvillim përkatës ekonomik-shoqëror.

Në ndryshime të tilla bëjnë pjesë ndryshimet teknologjike në bazë të të cilës mbështeten zhvillimi i teknologjive informative dhe komunikuese që njëherit edhe transformojnë jetën ekonomike-shoqërore. Veprimtaria edukative - arsimore, patjetër të zhvillohet dhe të hapërojë me kohën, me ç'rast me kujdes duhet të ndryshohen programet mësimore, përkryhet puna organizative, kadrovike dhe teknike. Reforma arsimore duhet të jetë e menaxhuar mirë për të arritur kredibilitet dhe për të arritur objektivat.



Mungesa e përvojës në administratë mund të ngadalësojë procesin e zhvillimit të ndonjë plani strategjik. Shkollat dhe klasat e bashkëngjitura që janë ndërtuar ose riparuar duhet të mirëmbahen dhe pajisen. Procesi i zhvillimit të programeve të mësimdhënësve në koordinim me sektorin e planprogramit në MASHT-it, duhet të vazhdohet sipas planit strategjik dhe

programeve të ndryshme për trajnim të mesimdhënësve, (duke filluar me FSDEK) duhet të shtohen dhe të mbahen me qëllim të zhvillimit të burimeve njerëzore. Mirëpo, shpesh ndodh që shkollat janë ndërtuar por nuk janë të mirëmbajtura ose pajisura mirë, ose projektet nuk janë zhvilluar duke marrë parasysh problemet e parashikuara. Kjo prezanton pengesa serioze në qëndrueshmërinë e projektit.

Prandaj, është e domosdoshme të ketë një plan të ndërgjegjshëm për zhvillimin e procedurave administrative, përfshirë planifikimin e politikave, buxhetimin, monitorimin dhe vlerësimin, komunikimin, konstruktimin dhe mirëmbajtjen e objekteve, krijimin e bazës së të dhënave dhe analizat, zhvillimin e planprogramit, kërkimeve dhe trajnimit e vazhdueshëm të personelit arsimor.

Është shumë me rëndësi që rezultatet të përfshijnë orare specifike, ashtu që aktivitetet të kryhen sipas planit. Një faktor tjetër i rëndësishëm në zhvillimin dhe implementimin e planit strategjik është përgatitja e fondeve të domosdoshme për të financuar realizimin e programit dhe projekteve relevante në sistemin arsimor. Sistemi arsimor në Kosovë është në prag të reformave për të riparuar dëmet nga lufta dhe konfliktet tjera. Në anën tjetër, ekonomia dhe buxheti i Kosovës ka mundësi të limituara për t'i përmbushur nevojat buxhetore për MASHT-in. Bazuar në këto fakte, MASHT, në bashkëpunim me strukturat tjera të qeverisë, duhet të bëjë përpjekje të gjejë fonde alternative përmes donatorëve lokal dhe ndërkombetar. Në vitet 2002-2009, MASHT ka punuar dhe do të vazhdojë të punojë për këtë qëllim me donatorët në projekte konkrete për zhvillimin e sistemit arsimor. Koha e zbatimit do të vendoset sipas volumit të punës që ka për t'u bërë, që ka nevojë të jetë e vlerësuar në mënyrë të duhur me qëllim që të arrihen rezultate cilësore. Një faktor tjetër i rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e planit strategjik është përgatitja e fondeve të domosdoshme për të financuar realizimin e programit dhe projekteve relevante në sistemin arsimor.

3.1. Dinamika e reformave arsimore në Kosovë

Në Kosovë, në dhjetë vitet e fundit, janë bërë ndryshime të shumta në të gjitha fushat e jetës. Njëra prej fushave ku janë bërë dhe po vazhdojnë të bëhen ndryshime të dukshme është arsimi.

Në këtë drejtim vëmendje e veçantë i është kushtuar reformimit të sistemit arsimor. Reformat janë bërë me ndihmën e organizatave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, ndërkombetare dhe vendore.

Reformat janë fokusuar në disa rrafshe. Këto rrafshe përfshijnë ndërtimin e shkollave, përgatitjen profesionale të mësimitdhënësve (me anë të trajnimeve të ndryshme), zhvillimin e kurrikulës, përmirësimin e cilësisë në arsim etj.

Dinamika e zhvillimit të reformave arsimore lidhet drejtpërdrejt me angazhimin e personave kompetent dhe gatishmërinë e tyre për të kontribuar në këtë aspekt. Tashmë është e ditur se synimet e shoqërisë kosovare janë për të qenë një shoqëri demokratike. Këto synime mund të realizohen vetëm me ndihmën e kultivimit të vlerave demokratike. Kultivimi i këtyre vlerave është i pamundur pa edukimin qytetar. Edukimi për Qytetarinë Demokratike (EQD) është me rëndësi të veçantë për avancimin e proceseve demokratike në vendin tonë. Qëllimi kryesor i EQD është përgatitja dhe aftësimi i gjeneratave të reja për të qenë faktor relevantë për të ndihmuar proceset demokratike, jo vetëm në bashkësinë ku ata jetojnë, por edhe më gjerë. Edukimi për qytetari demokratike do të thotë të mësosh gjatë gjithë jetës, në të gjitha rrethanat dhe në çdo formë të veprimtarisë njerëzore.



Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Ministrave Rec (2002) 12 për edukimin për qytetari demokratike, e bën të qartë që të gjitha nivelet dhe linjat e sistemit arsimor duhet të angazhohen në implementimin e EQD në programin mësimor, qoftë si lëndë specifike shkollore, si një lëndë të integruar në kuadër të lëndëve të tjera, apo si temë e programeve tjera.

Rekomandimi thekson nevojën për qasje multidisiplinare, për të lehtësuar përvetësimin e dijes, qëndrimeve dhe shkathtësive që kërkohen për t'iu mundësuar njerëzve jetë të përbashkët në një shoqëri pluraliste dhe demokratike.

Duke pasur këtë parasysh, është e rëndësishme që të mbahet mend që EQD: duhet të jetë në themel të reformave dhe të zbatimit të politikave arsimore është një faktor i rëndësishëm për risitë në fushën e organizimit dhe të menaxhimit të sistemeve arsimore, si dhe të kurrikulës dhe të metodave të mësimdhënies.

EQD përfshin një numër mjedisësh të të nxënësve, si në kuadrin e institucioneve shtetërore po ashtu edhe jashtë tyre. Edukimi për qytetari demokratike luan rol esencial në reformat e arsimore që po kryhen në shumë vende të Evropës.

EQD konsiderohet si përparësi e politikave arsimore të këtyre vendeve. Këto dhe arsye të tjera ndikojnë që politikën arsimore në Kosovë të fokusohen në edukimin qytetar me një seriozitet më të madh.

•••

Kohëve të fundit, në Kosovë, për qytetarinë po zhvillohen edhe debate të ndryshme, prej nga rezulton fakti se, një nga çështjet më shumë rëndësi për qytetarët e Kosovës është edhe ngritja e nivelit të njohjes së koncepteve që lidhen direkt me qytetarinë.

Konceptet janë mjete të dobishme për nxënësit. Ato ndihmojnë nxënësit që më lehtë të kuptojnë dhe të mbajnë në mend informacionet e reja. Mund të themi se, në njërin anë konceptet e qytetarisë përdoren posaçërisht si përpjekje për të stabilizuar dhe modifikuar disa praktika që përfshijnë shkollat tona, dhe në anën tjetër, përmes tyre synohet të arrihet edukimi i përgjithshëm qytetar. Gjithashtu, njohja e koncepteve ndihmon që nxënësit të pranojnë ndryshimet që po ndodhin gjatë viteve të fundit në Kosovë.

Edhe pse pjesa më e madhe e studimeve më të reja në fusha të ndryshme sociale, pajtohet me mendimin se shoqëria jonë ka ndryshuar në mënyrë radikale, këtu ka ende shumë punë për të bërë. Krahas kësaj, kanë ndryshuar edhe konceptimet teorike të qytetarisë.

Këto ndryshime nuk burojnë vetëm nga traditat e ndryshme kulturore dhe sociale, por ato reflektojnë gjithashtu mënyrat e ndryshme të vlerësimit të shoqërisë kosovare dikur dhe sot.

3.2. Arsimi në këndvështrimin e reformave

Arsimi është një nga fushat më të rëndësishme të çdo shoqërie dhe të çdo sistemi. Përmes arsimimit shoqëritë dhe kombet ju transmetojnë pjesëtarëve të tyre: dijen, kulturën, trashëgiminë kulturore, vlerat përmes të cilave shkon përpara shoqëria.

Arsimi është edhe një nga fushat që, jo vetëm i prin shoqërisë, por edhe ndikohet fuqishëm prej saj dhe ndryshimeve shoqërore. Fakti që sistemet e arsimimit janë në ndryshim të përhershëm, nuk tregon paqëndrueshmëri, përkundrazi, ato shërbejnë për t'iu përshtatur sa më mirë ndryshimit të shoqërisë.

Ashtu siç ka ndodhur edhe në sistemin tonë shkollor, ndryshimet e shpeshta të bëra këto dhjetë vitet e fundit, kanë treguar se arsimi është munduar të përshtatet sa të mund me ndryshimet sociale në vendin tonë, por edhe me ato globale. Këto ndryshime duke mos qenë shumë të studiuara dhe duke qenë se bëheshin në një terren shumë pak të favorshëm nga gjendja në të cilën sistemi ynë arsimor vinte dhe nga një politizimi i skajshëm, jo gjithmonë kanë dhënë frytet e duhura dhe janë perceptuar shpesh si eksperimente.

Eksperimentimi në arsim nuk është diçka e keqe, por kur ky eksperimentim kalon caqet hapësinore dhe kohore, atëherë ai bëhet i dëmshëm dhe ndikon negativisht.

Reformat e fundit në arsim dhe debatet që e kanë shoqëruar atë dëshmojnë për një rritje të ndërjegjësimin të shoqërisë për problemet e arsimit dhe të shkollës. Këto probleme duket se i përkasin gjithë shoqërisë dhe jo vetëm një pjese të saj. Reformimi i arsimit tashmë ka prekur të gjithë sistemin arsimor dhe duket se po kulmon me ligjin për arsimin e lartë. Duke qenë se intensiteti i reformave ka qenë i madh dhe koha e kryerjes së tyre relativisht e shkurtër, janë vënë re dhe po dalin në pah shumë problematika.

Është e kuptueshme që vetëm me një reformim të tillë problemet nuk mund të zgjidheshin përnjeherë. Kështu dolën në pah problematikat të cilat në disa raste, nëse nuk trajtohen me seriozitetin e duhur mund të lënë pasoja të rënda në arsimimin e brezave.

Reforma në arsim ka përfshirë legjislaicionin, kurrikulat, infrastrukturën, por për fat të keq ende nuk ka një reforme ose ende nuk është vënë në zbatim një reformim i burimeve njerëzore, d.m.th., i kuadrit dhe emërimeve në arsim.

Përsa i përket reformës së kurrikulës, janë bërë përparime të dukshme që e sjellin arsimin shqiptar pranë standardeve të vendeve të tjera.

Ky reformim nuk duhet parë i ndarë, d.m.th, i copëzuar dhe i rastësishëm, pasi nëse e shohim kështu nuk do të arrijmë të perceptojmë gjithë ndryshimin që është kryer. Duke filluar me sistemin 9- vjeçar, gjimnazin e ri, albertekstin, maturen shtetërore, etj.

Reformat e kryera, shpeshherë edhe me ngut, e kanë gjetur të papërgatitur mësuesin për të përballuar gjithë këto ndryshime.

Nëse synimi dhe arritja kryesore e kurrikulës së re dhe reformës ka qenë ndryshimi i konceptimit në arsim, pra vënia në qendër e nxënësit, kjo jo nga të gjithë mësuesit është kuptuar, ose është kuptuar në mënyrë sipërfaqësore. Të vendosësh nxënësin në qendër të mësimit nuk do të thotë të mjaftohesh duke përdorur disa teknika mësimdhënieje që në literaturën pedagogjike njihen si "teknika të të mësuarit më në qendër nxënësi", por duhet të ndryshohet mendësia e mësimdhënies, duhet ndryshuar këndvështrimi.

Mësimi dhe shkolla duhet t'i shërbejë nxënësit dhe nëse kjo nuk arrihet misioni mund të quhet i porealizuar, për të mos thënë i dështuar. Ende sot, ka mësues që e shohin nxënësin si objekt dhe jo si subjekt.

Harrojnë se tek çdo individ ka një veçori të cilën sistemi arsimor dhe veçanërisht mësuesi duhet ta vërë në dukje. Tek nxënësit shohin problemin dhe jo zgjidhjen; nxënësit i vënë në dukje dobësitë, por jo arritjet.

Ky këndvështrim, edhe pse nuk është keqdashës bëhet shkak për krijimin e situatave të pakëndshme në mësim.

3.3. Ndikimi i shoqërisë

Nëse kjo reformë po shfaq problematikën e saj, kjo nuk do të thotë se duhet të kthehemi pas, por të shohim shkaqet e problemeve dhe të gjejmë rrugë zgjidhje më të mira. Problematika më e bujshme dhe më shqetësuese, sa herë që fillonte viti shkollor kishte të bënte me tekstet. Mungesa e tyre, shitja në mënyrë të paligjshme, cilësia e dobët, sasia e pamjaftueshme dhe mbi të gjitha përmbajtja e tyre dhe ngarkesa e madhe me mangësi në aparatit pedagogjik, u kthyen në një problem tjetër që shoqëroi shkollën gjatë viteve të tranzicionit. Reforma e Albertekstit në arsimin parauniversitar zgjidhë shumë prej problemeve të ngritura. Nuk mund të pretendohet se cilësia dhe niveli shkencor apo pedagogjik i tyre arriti standardet më të larta, por kjo reformë e futi arsimin në një rrugë të mbarë dhe ndikoi shumë në ndryshimin e perceptimit të tekstit, jo si mjete më të rëndësishme të mësimdhënies, por si një mjet i nevojshëm për nxënësin. Ajo që duket se mbetet e porealizuar në këtë reformë,

ka të bëjë me mësuesin. Për sa kohë do të ketë mësues që për probleme të ndryshme apo paqartësi apo edhe gabime shkencore do të shfaqësohen se "kështu e ka teksti", mund të thuhet me bindje se reforma nuk është kuptuar si dhe sa duhet. Shtëpitë botuese nga dëshira për të qenë sa me konkurruese në treg harrojnë se nuk kanë të bëjnë me një produkt konsumi, por me një material të rëndësishëm për formimin e brezave. Ajo që mund të dëmtojë seriozisht këtë reformë dhe rrjedhimisht edhe sistemin arsimor, ka të bëjë me interesat klienteliste të shtëpive botuese dhe autorëve të teksteve.

Për miratimin e teksteve është mirë të zbatohet një procedurë më e hapur dhe më transparente, duke përfshirë më shumë mësuesit si zbatues dhe njohës më të mirë të programeve dhe problematikave shkollore. Kështu mund të shmangët çdo ndikim nga jashtë dhe monopolizim i dëmshëm. Një reformë nuk mund të kuptohet pa burimet njerëzore që i japin asaj vlerën e vërtetë. Mjafton t'i hedhesh një sy librit të transparencës dhe kupton se sa pak kërkohet ky profesion madje edhe kur kërkohet, fatkeqësisht jo prej nxënësve shumë të mirë.

Duke u ndalur tek zhvillimet në arsim, nuk mund të mos përmendësh infrastrukturën dhe mjediset shkollore, që në këto vite ka ndryshuar shumë. Sot një pjesë e mirë e shkollave të qyteteve të mëdha dhe qendrave të rëndësishme urbane kanë një infrastrukturë bashkëkohore.

Është e vërtetë që numri i nxënësve në klasë ka një shpërndarje jo uniforme, por kjo është pasojë e lëvizjeve demografike të mëdha dhe ndryshimeve që po pëson struktura e popullsisë. Problematika në infrastrukturë dhe mjediset shkollore shfaqet tek menaxhimi i tyre. Sot një drejtues shkolle apo drejtorja e saj pothuajse nuk kanë asnjë kompetencë për sa i përket administrimit të mjediseve shkollore. Një drejtor shkolle nuk mund menaxhojë dot mjedis shkollor sipas interesave të shkollës dhe komunitetit, sepse në radhë të parë shkolla nuk ka buxhet të mjaftueshëm dhe nuk ka asnjë ligj që rregullon këto marrëdhënie. Kështu edhe nëse një drejtues do të bëjë përpjekje për të përmirësuar gjendjen në shkollën e tij, këto më shumë do të realizohen si favore për hatër të drejtorit sesa si punë dhe ndihmë për shkollën.

Që drejtori të mos jetë më kryemësues, por menaxher i shkollës i duhet dhënë atij roli që i takon edhe ligjërisht, por edhe përgjegjësia dhe kompetenca.

3.4. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore

Klasifikimi i shkollave sipas standardeve bashkëkohore për të njohur më mirë gjendjen e infrastrukturës shkollore dhe për të ndihmuar në përmirësimin e shkollave me më shumë probleme. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore nëpërmjet ndërtimeve të reja, rehabilitimeve dhe zgjerimit të kapaciteteve të atyre ekzistuese.

Vendosja e inxhinierëve në zyrën arsimore pranë komunës që të vlerësojnë nevojat reale të shkollave, punë kjo e cila deri tani është realizuar nga drejtorët e shkollave.

Ndarja në godina të ndryshme e ciklit të ulët nga ai nëntëvjeçar për shkollat me numër të madh nxënësish. Mënjanimi i mungesave në furnizim me energji elektrike në shkollë gjatë orëve të mësimin nëpërmjet gjetjes së formave alternative të furnizimit me energji.

1. Pajisja me mjete didaktike

Krijimi i hapësirave të specializuara për zhvillimin e procesit mësimor si laborator, bibliotekë, palestër, sallë interneti, etj.

Pajisja sistematike e shkollave me sasinë dhe cilësinë e duhur të pajisjeve dhe materialeve didaktike funksionale, të përshtatshme për mjedisin dhe që aksesohen nga mësuesit.

Krijimi i një qendre lokale për prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve apo pajisjeve didaktike sipas një grafiku rezervimesh.

2. Buxheti

Rritja e buxhetit të shtetit për arsimin

Krijimi i një buxheti për shkollat, që do të përcaktohet duke u bazuar në nevojat specifike.

Hapja e një numri llogarie për secilën shkollë në mënyrë që stafi të motivohet për bashkëpunime me bizneset lokale, organizatat ndërkombetare, bankat, etj.

Manaxhimi me transparencë i fondeve të shkollës

3. Rritja e cilësisë së trajnimit dhe të kualifikimit fillestar dhe në punë të mësuesve

Motivimi i studentëve më të mirë për të përqaftuar profesionin e mësuesisë nëpërmjet bursave.

Përmirësimi i nivelit të trajnimit fillestar të mësuesve në fakultetet e edukimit.

Ngritja e sistemit të trajnimit dhe të kualifikimit; vendosja e certifikimit, akreditimit dhe motivimit të mësuesve dhe drejtorëve mbi kritere profesionale.

3. Trajnimi

Trajnimi teknik i mësuesve për përdorimin e pajisjeve apo aparaturave.

Mundësimi nga ekspertë vendas dhe të huaj i mbështetjes së stafit të shkollës me trajnim cilësor dhe bazuar në nevojat dhe kërkesat e kohës.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i fortë i institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore për realizimin e trajnimeve dhe kualifikimeve për stafet.

Përzgjedhja e stafeve në shkolla bazuar mbi kërkesa bazë lidhur me arsimimin dhe eksperiencën.

Rishikimi i kurrikulës

Rishikimi i kurrikulave të arsimit nëntëvjeçar, duke u bazuar në standardet bashkëkohore. Hartimi dhe zbatimi i një sistemi vlerësimi të unifikuar dhe sipas standardeve për të minimizuar vlerësimin subjektiv, me opinione apo të diferencuar të nxënësve. Shmangia e ngarkesës së tepërt lëndore për nxënësit.

Planifikimi i veprimtarive në shkollë

Planifikim i kujdesshëm i ngarkesës javore të orëve të mësimit për mësuesit.

Mbështetja dhe forcimi i shërbimeve të specializuara brenda shkollës për kryerjen e misionëve të tyre.

Gjetja e rrugëve dhe metodave efikase për zbutjen e kalimit nga cikli fillor në atë nëntëvjeçar për të shmangur braktisjen që vihet re gjatë këtij kalimi.

Shtimi i numrit dhe llojshmërisë së veprimtarive jashtëmësimore, bazuar në interesat aktuale dhe afatgjata të nxënësve.

Organizimi i veprimtarive të përbashkëta ndërmjet shkollave të të njëjtit nivel nëpërmjet Drejtorisë Arsimore.

Krijimi i shkollave mbështetëse dhe miqësore, veçanërisht për fëmijët në rrezik.

Trajtimi i çështjes së fëmijeve në moshë të rritur, të cilët ende nuk janë të regjistruar në shkollë.

Bashkëpuimi me prindërit dhe komunitetin

Përfshirja në vendimmarrje e të gjitha palëve të interesuara si: nxënësit, stafi, prindërit, institucionet, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, etj.

Trajnimi i prindërve për problemet social-psikologjike të moshave të ndryshme shkollore.

Mbështetja konkrete për familjen e fëmijës për të kapërcyer problemet.

Rregullimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor

Zbatimi i ligjshmërisë për prindërit që i largojnë fëmijët e tyre nga shkolla për çfarëdo lloj arsyeje. Rregullimi i kuadrit ligjor për ta bërë të detyrueshëm arsimin e mesëm.

4. Reformat arsimore në Komunën e Prizrenit

Reformimi i arsimit tashmë ka prekur të gjithë sistemin arsimor dhe duket se po kulmon me ligjin për arsimin e lartë. Duke qenë se intensiteti i reformave ka qenë i madh dhe koha e kryerjes së tyre, relativisht e shkurtër, janë vënë re dhe po dalin në pah shumë problematika. Është e kuptueshme që vetëm me një reformim të tillë problemet nuk mund të zgjidheshin përnjeherë. Duke u ndalur tek zhvillimet e arsimit, nuk mund të mos përmendesh infrastrukturën dhe mjediset shkollore që në këto vite ka ndryshuar shumë. Sot një pjesë e mirë e shkollave të qyteteve të mëdha dhe qendrave të rëndësishme urbane kanë një infrastrukturë bashkëkohore.

Reformat e arsimit gjithashtu edhe shkollat e Prizrenit i shndërruan në shkolla bashkëkohore, të cilat ishin në gjendje jo të mirë, si në aspektin e procesit mësimor ashtu edhe në infrastrukturë.

Këto janë disa pikëpamje rreth reformimit të sistemit arsimor në vija të përgjithshme, të para në këndvështrimin e problematikave që janë të mundshme të zgjidhen pa pasur një kosto të lartë dhe pa dhënë efekte të padëshirueshme.



Për zgjidhjen e tyre mjafton vetëm pak dëshirë dhe respektim të ligjshmërisë dhe praktikave. Për këtë duhet njohje dhe përhapje më e gjerë e informacionit të ri që aktorët e këtyre ndryshimeve të dinë se si dhe ku ta gjejnë vetën në këtë sistem, që është në reformim të vazhdueshëm.

Profesionalizimi i mësuesve, që nënkupton kompetenca profesionale, trajnim/zhvillim gjatë punës, efikasitet dhe efëcenceë individuale, mbështetet mbi dijet shkencore dhe ato profesionale. Sigurisht, me këtë nuk mohohet rëndësia e disiplinës akademike, por parësore del tani nevoja për t'i riorganizuar këto dije në programet e formimit të mësuesve, në thellësi dhe gjërësi; për t'i lidhur ato me përmbajtjet e lëndëve që mësuesi do të zhvillojë në shkollë dhe mbi të gjitha, për të mos i konsideruar me disiplinat akademike, si qëllim i formimit universitar, por si një nga burimet e formimit të kompetencave profesionale, që nxënës-mësues ndërtojnë në sallat e nxënies e më tej.

Pa e reduktuar dijen universitare në nivelin e programeve shkollore, mendoj se tashmë, dija akademike duhet rivlerësuar nga pikëpamja e profesionalizimit të mësuesisë, duke e plotësuar atë me elementet që lidhen me historinë e lëndës shkollore, me epistemologjinë e saj dhe me lëndët e tjera.

Mund të presim që mësuesi i ardhshëm të përvetësojë dije të sofistikuara dhe të baraspeshuara rreth nxënësit, lëndës mësimore dhe pedagogjisë.

Reformat arsimore në komunën e Prizrenit po rrjedhin e zbatohen në një ritëm të mirë dhe po zhvillohen në mënyrë të mirë, si në të gjitha komunat tjera në Kosovë, pra me të njëjtin ritëm në përgjithësi.

Edhe pse pjesa më e madhe e studimeve të reja në fusha të ndryshme sociale, pajtohet me mendimin se shoqëria jonë ka ndryshuar në mënyrë radikale, këtu ka ende shumë punë për t'u bërë. Krahas kësaj, kanë ndryshuar edhe konceptimet teorike të qytetarisë.

Këto synime mund të realizohen vetëm me ndihmën e kultivimit të vlerave demokratike. Kultivimi i këtyre vlerave është i pamundur pa edukimin qytetar.

4.1. Procesi i përgatitjeve

Për këto dhjetë vite që kaluan, është arritur që arsimit në Prizren, jo vetëm të stabilizohet në krahasim me gjendjen e viteve paraprake, por edhe të bëhet i krahasueshëm me vendet që kanë arsim të përparuar. Kështu, krahas shumë aktiviteteve, konsiderojmë se me sukses është duke u realizuar edhe reforma e sistemit arsimor në të gjitha nivelet. Në këtë drejtim janë duke u shfrytëzuar ndihmat dhe përvojat e vendeve më të përparuara të botës bashkëkohore.

MASHT të Kosovës angazhohet që të krijohen kushte sa më të mira për realizimin e procesit arsimor. Të arritura e sotme në arsimin e Prizrenit janë evidente, por natyrisht asnjëherë nuk është e mjaftueshme kur kemi të bëjmë me arsimin dhe nedojat kjo veprimtari shoqërore ka për investime dhe ndryshime pozitive. Këto të arritura nuk janë vetëm fryt i punës së institucioneve të Prizrenit, por janë arritur, para se gjithash, falë punës fisnike dhe angazhimit të sinqertë të vetë mësimitdhënësve.

Kështu jo vetëm synimet e MASHT të Kosovës, por edhe të institucioneve tjera të Prizrenit, duhet të orientohen për t'i përmbushur këto objektiva. Disa prej këtyre objektivave në Prizren janë realizuar. Por, synimi për të siguruar arsimim cilësor për fëmijët tanë duhet të jetë prioritet dhe angazhim i vazhdueshëm. Këtë synim mund ta arrijnë vetëm duke bashkëpunuar me të gjithë faktorët relevante, sidomos me ata të cilët në shpirt e kanë prioritet arsimin. Ndër aktivitet tjera për këtë vit MASHT ka përcaktuar edhe përgatitjen e strategjisë afatmesme për arsimin parauniversitar.

Përcaktimi për këtë aktivitet ka për bazë edhe:

Kompletimin e tërë sistemit arsimor me strategji përkatëse, krahas me Strategjinë Arsimit të Lartë që është në zbatim e sipër, harmonizimi me reformat e arsimit në Evropë deri në vitin 2010 obligimet tjera.

Procesi për përgatitjen e Strategjisë së Arimit Parauriverstar nënkupton:]

Është angazhuar një agjenci implementuese për zhvillimin e veprimtarive që kërkojnë ekspertizë (Qendra për Arsim e Kosovës, e njohur si KEC).

Po ashtu, është caktuar një ekspert konsulent për tërë procesin e zhvillimit të strategjisë. Është ngritur grupi për komunikim lidhur me aktivitetet përkatëse.

Pra, janë organizuar një serë punëtorish me pjesëmarrje nga nivele, aspekte, segmente dhe sektore të ndryshëm të sistemit arsimor, të cilat janë zhvilluar prej identifikimit të dobësive dhe të arriturave, përmes përcaktimit të fushave të trajtuara, definimit të vizionit, misionit, objektivave strategjike zhvillimore drejt masave dhe veprimeve konkrete për çuarjen përpara të sistemit arsimor kah do të ecë shoqëria kosovare në të ardhmen.

Ekspertët, zyrtarët dhe mësimdhënësit, që morën pjesë në procesin e hartimit të strategjisë, me qëllim të analizës sa më të mirë të gjendjes dhe të perspektivave në sistemin e arsimit, vendosën që ta ndajnë informacionin dhe realitetin arsimor të Prizrenit në shtatë fusha problemore:

Këto fusha janë:

Kapacitetet menaxhuese të sistemit,

Cilësia dhe efektiviteti,

Përfshirja dhe barazia në arsim,

Përgatitja dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Infrastruktura,

Arsimi dhe shoqëria dhe,

Baza materiale e arsimit.

4.2. Vizioni dhe misioni

Me këtë strategji Prizreni duhet të shndërrohet në një shtëpi të madhe të të nxënit, sepse vetëm nëse qytetarët e Kosovës aftësohen që të mësojnë gjatë gjithë jetës, ata do të aftësohen që të komunikojnë, të planifikojnë, të mendojnë në mënyre kritike, të përdorin dy e më shumë gjuhë të huaja, të përdorin teknikën dhe teknologjinë e re. Vetëm qytetarët, që përherë janë në kërkim të dijeve të reja dhe të qëndrueshme, do të jenë në gjendje të lëvizin, të gjejnë punë të re, të kenë mirëqenie dhe të jenë të lumtur. Duke u nisur nga Sfort-analiza e gjendjes ekzistuese të arsimit në Kosovë, duke pasur parasysh parimet universale të ndryshimeve në arsim dhe duke synuar integrimin e arsimit të Kosovës në rrjedhat e sistemeve demokratike të shteteve të zhvilluara, sidomos të Unionit Evropian, është formuluar ky vizion:

Kosova - shoqëri e dijes, e integruar në rrjedha evropiane me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë individëve, të cilët i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror. Realizimi i këtij vizioni në Prizren, e cila ende është duke u përpëlitur me etapën e vështirë të transicionit, të statusit të pazgjidhur politik, me një ndasi etnike ndërmjet shumicës së popullsisë dhe të bashkësisë etnike serbe, nuk do të jetë lehtë. Do të nevojitet shumë kreacion, gjithëpërfshirje, angazhim të një numri të madh partnerësh. Në anën tjetër, deri sa Kosova përballet me këto probleme, bota lëvizë me një shpejtësi marramendëse drejt një shoqërie dhe ekonomie të bazuar mbi dije. Më shumë se kurrë Prizreni, për t'u integruar në shoqërinë e dijeve, ka nevojë që për të zënë hapin e integritimeve evropiane. Besojmë plotësisht se vizioni i përcaktuar është një ëndërr e përbashkët e të gjithë kosovarëve, të cilët duhet të punojnë që këtë (ëndërr) ta bëjnë realitet. Ky vizion është edhe zgjidhja më fatlume për perspektivën e brezave të rinj të Kosovës. Jetësimi i këtij vizioni Prizrenit do t'i mundësojë që të jetë pjesë e barabartë e botës së civilizuar, që do të veçohet me kohezion të fuqishëm social dhe me mirëqenien e të gjithë qytetarëve të saj. Përmes misionit krijohen kushtet që të realizohet vizioni i paraparë.

Misioni i kësaj strategjie është:

Ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor të të gjithë individëve, duke kultivuar shprehi të nxënit gjatë gjithë jetës dhe vlera të qytetarisë demokratike. Realizimit të misionit do t'i kontribuojnë jetësimi i mekanizmave për përparimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të sistemit të arsimit dhe për aftësimin e qytetarëve për të

nxënë gjatë gjithë jetës dhe në dritën e qëllimeve strategjike të Unionit Evropian, si dhe të kërkesave që i parashtron shoqëria e dijes. Misioni paraqet një obligim për sistemin e arsimit në Prizren, një rrugë për t'i kontribuar arritjes së vizionit të përbashkët.

4.3. Objektivat strategjike

Grupet e ekspertëve kanë identifikuar shtatë objektiva strategjike, të cilat duhet të arrihen në periudhen dhjetë vjecare. Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor dhe efikas në sistemin e arsimit.

Sistem funksional për sigurimin e cilësisë së të nxënit i bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e zhvilluara. Gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim i diversitetit në arsim, sistem efektiv për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të personelit arsimor.

Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe të nxënë.

Lidhje e qëndrueshme e arsimit me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore. Përparimi i gjendjes materiale të arsimit.

Këto objektiva nuk janë radhitur sipas ndonjë përparësie, sepse secila prej tyre konsiderohet e rëndësishme për përparimin e sistemit të arsimit parauniversitar.

Ndërkaq, për secilën objektive strategjike janë definuar:

Treguesit objektivisht të verifikueshëm, që dëshmojnë arritjen e objektivës në fjalë, masat (aktivitetet) që paraqesin veprimet e ndërmarra për arritjen e objektivave strategjike, ku shumë sosh (masa) janë projekte në vete, të cilat duhet të elaborohen më tutje. Është bërë edhe përshkrimi i masave përkatëse dhe secila masë paraqet një projekt në vete.

5. Kushtet e punës dhe të shkollës

Arritjet e nxënësve

Ndjekja e arritjeve të nxënësve me përkatësi të ndryshme gjinore, etnike (dhe gjuhës së mësimimit në lëndët mësimore dhe sipas periudhës kualifikuese.

Përmirësimi i arritjes së nxënësve me përkatësi të ndryshme gjinore dhe etnike (dhe gjuhës së mësimimit).

Identifikimi i nxënësve që kanë vështirësi në mësim, të nxënësve me talent të veçantë dhe të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Përmirësimi i arritjes së nxënësve përmes mësimimit të rregullt dhe plotësues,

Ndjekja e arritjes së nxënësve gjatë kalimit prej një cikli në një tjetër dhe prej një niveli në një nivel tjetër arsimor.

Shkolla disponon me të dhëna për arritjen e nxënësve, sipas përkatësisë gjinore dhe etnike (dhe sipas gjuhës mësimore), në të gjitha lëndët mësimore dhe për të gjitha periudhat kualifikuese.

Shkolla krijon bindjen se arritjet e nxënësve mund të përmirësohen. Sipas pasqyrës në arritjet aktuale të nxënësve (të fituara përmes testeve interne dhe të jashtme), shkolla planifikon dhe ndërmerr aktivitete të ndryshme për përmirësimin e vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve të përkatësive të ndryshme gjinore dhe etnike (dhe sipas gjuhës mësimore).

Shkolla ka sistem për identifikim të nxënësve që kanë vështirësi në mësim, të nxënësve me talent të veçantë, si dhe të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe vazhdimisht ndjek përparimin e tyre.

Në procesin e rregullt mësimor, shumica e mësimdhënësve mbështesin nxënësit që kanë vështirësi në mësim, nxënësit me nevoja të veçanta mësimore, si dhe nxënësit me talent të veçantë, duke zgjedhur aktivitete adekuate sipas nevojave dhe mundësive të tyre. Gjatë tërë vitit, shkolla realizon mësim plotësues nga të gjitha lëndët, për të cilat nxënësit kanë vështirësi dhe mësim plotësues për nxënësit të cilët tregojnë rezultate të mëdha në disa fusha.

Shkolla, në mënyrë të vazhdueshme ndjek arritjen e nxënësve gjatë kalimit prej një cikli në një cikël tjetër dhe pas mbarimit të shkollës fillore dhe të mesme. Në qoftë së paraqiten ndryshime në arritjet e tyre gjatë kalimit prej një cikli në një cikël tjetër, shkolla i analizon shkaqet për një dukuri të këtillë dhe ndërmerr aktivitete për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Një numër i madh i mësimdhënësve në procesin e rregullt mësimor, mbështesin nxënësit që kanë vështirësi në mësim, nxënësit që kanë nevoja të veçanta mësimore, si dhe nxënësit e talentuar. Shkolla realizon mësim plotësues në fund të vitit shkollor për të gjithë nxënësit që kanë notat e dobëta në disa lëndë.

5.1. Përvojat e nxënësve nga mësimi

- **Ambient për mësim**
- **Atmosfere për mësim**
- **Nxitja e nxënësve për marrjen e përgjegjësisë**

Mënyre interaktive e sjelljes së nxënësve midis veti dhe me të moshuarit në shkollë nxënësit i përjetojnë klasat dhe hapësirat e tjera shkollore si mjet motivues dhe stimulues që nxit interesin e tyre për mësim.

Punimet e nxënësve ekspozohen në vende të dukshme përkatëse (në shkollë dhe në klasë), duke respektuar norma estetike. Ato ndërrohen, në përputhje me qëllimet e mësimin dhe mësimdhënies çdo nxënës përfiton mundësinë që të ekspozojë ndonjë punim.

Nxënësit konsiderojnë se mënyra e mësimin në shkollë është interesante dhe ajo që mësohet është e lidhur me përditshmërinë. Gjatë orës së mësimin, pjesa më e madhe e mësimdhënësve i inkurajojnë nxënësit të mendojnë në mënyrë të pavarur, të shtrojnë pyetje dhe të nxjerrin përfundime për atë që mësojnë. Shumica e mësimdhënësve nuk i kritikojnë nxënësit para nxënësve të tjerë ose para të rriturve. Të gjithë nxënësit marrin pjesë aktive gjatë orës së mësimin. Nxënësit konsiderojnë se ka mundësi ta shprehin mendimin e vetë dhe që ai të merret parasysh në mënyrë serioze gjatë vendosjes dhe zgjedhjes së problemit. Nxënësit marrin mbi vete përgjegjësi të ndryshme në shkollë (gjatë mësimin dhe jashtë tij).

Nxënësit konsiderojnë se, shkolla nxit, motivon dhe realizon bashkëpunim midis nxënësve dhe të rriturve në shkollë, përmes formave të organizuara. Nxënësit punojnë bashkarisht në projekte të ndryshme, në mësim dhe jashtë tij me grupe me përbërje dhe madhësi të ndryshme.

Nxënësit konsiderojnë se në shkollë ka klasa të mjaftueshme dhe hapësira të tjera që nxisin interes për mësim. Punimet e nxënësve ekspozohen, por i kushtohet kujdes dukshmërisë dhe vendit ku ekspozohen ato, i kushtohet rëndësi qëllimit të ekspozimit dhe estetikës.

Nxënësit konsiderojnë se mësimi është interesant dhe ajo që mësohet është gjithnjë e lidhur me përditshmërinë. Një numër i mësimdhënësve i inkurajojnë nxënësit që të mendojnë në mënyrë të pavarur, të parashtrojnë pyetje dhe të nxjerrin përfundime nga ato që mësojnë. Shumë nxënës janë aktiv gjatë orës së mësimi.

Nxënësit mendojnë se kanë mundësi ta shprehin mendimin e tyre dhe ai të merret parasysh. Nxënësit janë përgatitur që të marrin përgjegjësi në mësim dhe jashtë tij.

Nxënësit mendojnë se bashkëpunimi midis nxënësve është i mirë dhe së shumica e të rriturve në shkollë janë të hapur për bashkëpunim me ta. Nxënësit punojnë në projekte grupore në to shihet llojllojshmëria.

5.2. Procesi mësimor shkolla dhe puna

- Forma dhe metoda mësimore
- Zgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve
- Marrëdhënie interaktive midis mësimdhënësve dhe nxënësve
- Sjellja e mësimdhënësve ndaj nxënësve
- Ndjekja e procesit mësimor

Shfrytëzohen metoda dhe forma të llojllojshme mësimore (duke përfshirë edhe përdorimin e teknologjive të informimit dhe komunikimit në mësim), të cilat janë në harmoni me nevojat e nxënësve dhe me stilin e tyre të mësimi. Mësimdhënësit shfrytëzojnë metoda mirë të planifikuara dhe adekuate që të punojnë me nxënësit edhe individualisht, në grupe të vogla ose me tërë paralelen. Mësimdhënësit, në mënyrë të suksesshme i zhvillojnë shkathtësitë individuale për mësim të secilit nxënës, si dhe shkathtësitë për bashkëpunim.

Detyrat që punohen në shkollë ose në shtëpi janë planifikuar mirë dhe janë të lidhura me punën e nxënësve gjatë orëve.

Zgjedhja e detyrave dhe aktiviteteve (me nivel të ndryshëm të ndërlikimit) i është përshtatur nevojave individuale arsimore të nxënësve, e cila gjithë ndihmon që nxënësit t'i arrijnë qëllimet e parashikuara të mësimi.

Mësimdhënësit shfrytëzojnë resurse dhe qasje të ndryshme për mësim dhe mësimdhënie, duke mos u kufizuar vetëm në librat e miratuara shkollore dhe në literaturën plotësuese. Nxënësve u mundësohet të punojnë me ritmin individual.

Mësimdhënësit i ndajnë së bashku me nxënësit qëllimet e mësimi dhe rezultatet e pritura nga mësimi dhe ato i kuptojnë të gjithë nxënësit në të gjitha fazat e mësimi. Mësimi është

adekuat me moshën dhe nivelin e arsimit të nxënësve. Shfrytezohen metoda të ndryshme interaktive me nxënësit, që inkurajojnë dhe nxisin mësimin dhe ndërtimin e besimit midis mësimdhënësve dhe nxënësve. Nxënësit nxiten që në mënyrë aktive të marrin pjesë në mësim dhe kontributi i tyre vlerësohet.

Mësimdhënësit shfrytezojnë qasje pozitive, në mënyrë që t'i motivojnë nxënësit (përmes levdatave kur është e nevojshme).

Mësimi në klasë është art dinamik dhe ka atmosferë pune

Të gjithë mësimdhënësit me nxënësit sillen me respekt dhe me mirëkuptim, duke ndihmuar dhe duke bashkëpunuar. Gjatë kësaj ata nuk bëjnë dallim midis nxënësve nga aspekti gjinor, social dhe etnik ose përkatësia fetare. Mësimdhënësit nuk shfrytezojnë stereotipe gjinore, etnike dhe fetare gjatë komunikimit me nxënësit dhe ndalojnë që edhe nxënësit të përdorin stereotipe të tilla.



Shkolla ka dispozita interne me ndjekjen e procesit mësimor dhe këto zbatohen rregullisht, ndërsa mësimdhënësin e vizitojnë në orë drejtori dhe shërbimi profesional, se paku dy herë në një gjysmëvjetor. Praktikohet që të këmbehen përvoja gjatë ndjekjes së punës së kolegëve nga

ana e grupit profesional. Rezultatet e ndjekjes së punës shfrytëzohen pastaj për përmirësimin e procesit mësimor.

Metodat dhe format mësimore, (duke përfshirë këtu edhe përdorimin e teknologjive të informimit dhe komunikimit në mësim) që i përdorin mësimdhënësit nuk përpudhen çdo herë me nevojat e nxënësve dhe nuk i përfshijnë të gjitha stilet e mësimin.

Mësimdhënësit punojnë individualisht me nxënësit, në grupe ose me tërë klasën, por metodat që i shfrytëzojnë nuk janë çdo herë të zgjedhura në mënyrë adekuate. Mësimdhënësit sillen kryesisht njëlloj me të gjithë nxënësit, gjë që nuk kontribuon për zhvillimin e shkathtësive individuale për mësim të secilit nxënë.

Një pjesë e mirë e mësimdhënësve sillen me nxënësit me respekt reciprok, duke ndihmuar dhe duke bashkëpunuar dhe me mirëkuptim, pa bërë dallime midis nxënësve sipas përkatësisë gjinore, sociale, etnike dhe fetare.

5.3. Infrastruktura dhe hapësira e shkollës

- Kushtet hapësinore
- Shfrytëzimi i kapaciteteve hapësinore

Hapësira shkollore i plotëson kushtet për mbajtjen e mësimin sipas rregullores. Ekzistojnë kushte adekuate të këndshme për zhvillimin e mësimin, për punën e kuadrit arsimor dhe për organizmin e aktiviteteve të lira me nxënësit. Madhësia e klasës përshatet me numrin e nxënësve nëpër paralele.



Shkolla ka orar dhe plan të qartë dhe i shfrytëzon maksimalisht kapacitetet disponuese për zhvillimin e mësimin dhe të aktiviteteve të lira, me çka i plotëson nevojat e nxënësve.

Shkolla ndërmerr aktivitete për përmirësimin e gjendjes ekzistuese. Është e nevojshme përshatja e kushteve hapësinore për të siguruar kushte të këndshme për zhvillimin e mësimin,

për punën e kuadrit arsimor dhe për organizimin e aktiviteteve të lira. Krahas numrit të madh të klasave që janë adekuate me numrin e nxënësve nëpër paralele, ndjehet mungesa e hapësirave për mbajtjen e mësimit praktik dhe të aktiviteteve të lira.

Shkolla mundohet të ndërmerre masa për shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve ekzistuese për zhvillimin e mësimit dhe të aktiviteteve të lira dhe si rezultat i kësaj, mësimsdhënësit shfrytëzojnë një numër të vogël të kapaciteteve hapësinore.

5.4. Puna financiare e shkollës

- Procedurat më të cilat sigurohet respektimi i rregullave ligjore për punën financiare. Transparence në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit shkollor. Procedurat për punën financiare që i zbaton shkolla janë në përputhje me normativat ligjore. Kuadri udhëheqës ka mirëkuptim për mekanizmat që mund t'i përdore për arritjen e mjeteve plotësuese financiare. Këshilli i shkollës është i njoftuar me aktivitetet financiare të shkollës. Kuadri udhëheqës e ndjek me vigjilencë shpenzimin e buxhetit, me qëllim që të fitojë cilësi adekuate për mjetet e shpenzuara financiare. Shkolla i informon organet dhe trupat e shkollës për buxhetin shkollor dhe për shpenzimet. Personat përgjegjës rregullisht diskutojnë për informatat lidhur me resurset dhe përmes vendimeve që i sjellin sigurojnë ekonomi, efikasitet dhe drejtësi në shpërndarjen e mjeteve financiare. Kuadri udhëheqës konsultohet me të gjithë të punësuarit kur është nevoja dhe në nivel adekuat deri në detaje. Përparësitë buxhetore janë të lidhura ngushtë dhe pasqyrojnë prioritetet dhe qëllimet arsimore të shkollës. Buxheti shfrytëzohet me dedikim dhe për qëllime kreative, të cilat janë të fokusuara për përmirësimin e cilësisë së mësimit dhe mësimsdhënies si dhe zhvillimit të shkollës në përgjithësi.

- Procedurat për punën financiare që i zbaton shkolla janë në përputhje me normat ligjore. Kuadri udhëheqës ka mirëkuptim për mekanizmat që mund t'i shfrytëzojë për arritjen e mjeteve plotësuese financiare. Këshilli i shkollës është i njoftuar për aktivitetet financiare të shkollës. Kuadri udhëheqës i ndjek shpenzimet e dedikuara të buxhetit me paragjykim se fiton cilësi adekuate për mjetet e shpenzuara financiare.

Shkolla i informon organet dhe trupat e shkollës për shpenzimin dhe buxhetin shkollor. Përparësitë buxhetore janë gjithmonë të lidhura dhe e pasqyrojnë përparësinë dhe qëllimet arsimore të shkollës. Buxheti shfrytëzohet për qëllime ose përparësi të cilat janë të lidhura me përmirësimin e cilësisë së mësimit dhe mësimsdhënies, si dhe me zhvillimin e përgjithshëm të shkollës.

5.5 Materialet dhe mjetet mësimore

Pajisje me literaturë profesionale, mjete mësimore dhe ndihmëse

- Biblioteka shkollore

- Materiali shpenzues

Shkolla disponon me literaturë të llojllojshme profesionale dhe mjete mësimore dhe ndihmëse në pajtim me Rregulloren për të gjitha lëndët mësimore. Shkolla i përcakton nevojat për mjete mësimore dhe ndihmëse, duke përfshirë aty librat, materialet për punë praktike, pajimet audio-vizuele dhe teknologjive të informimit dhe komunikimit dhe në mënyrë të vazhdueshme ripërtërin ato që të jenë në përputhje me rrjedhat bashkëkohore mësimore.

Mësimdhënësit dhe nxënësit dinë se cilat mjete mësimore dhe materiale të tjera kanë në dispozicion dhe të njejtat i shfrytëzojnë në mënyre efektive dhe efikase në mësimdhënie dhe në mësim. Mësimi dhe mësimdhënia janë të pasuruara përmes shfrytëzimit të planifikuar të teknologjive të informimit dhe komunikimit. Mësimdhënësit dhe nxënësit kanë qasje në internet.

Biblioteka shkollore disponon me më shumë se pesë tituj librash për një nxënës, duke përfshirë këtu edhe lekturat. Shkolla gjithashtu mban evidencën e rregullt të bibliotekës. Biblioteka është renditur bukur dhe disponon me kompjuter dhe qasje në internet. Biblioteka është e hapur për nxënësit gjatë tërë ditës shkollore.

Shkolla planifikon dhe siguron me kohë material shpenzues në sasi të mjaftueshme, për realizimin e aktiviteteve mësimore dhe aktiviteteve të lira sipas planit të shkollës.

Shkolla disponon me literaturë profesionale dhe mjete mësimore të cilat pjesërisht përputhen me rrjedhat bashkëkohore mësimore. Mësimdhënësit dhe nxënësit disa herë kanë qasje të kufizuar ndaj mjeteve mësimore dhe materialeve të tjera të nevojshme për mësim dhe mësimdhënie. Shkolla i përcakton nevojat për mjete mësimore dhe mjete ndihmëse, por nuk ka sistem për ndjekjen e përdorimit të tyre, për mirëmbajtjen dhe për blerjen e mjeteve të reja. Mësimdhënësit dhe nxënësit kanë qasje të kufizuar në internet.

Mbikëqyrje e drejtpërdrejt në dokumentacionin e shkollës për furnizimin e literaturës profesionale dhe mjeteve mësimore;

Bisedë me mësimdhënësit, me shërbimin profesional dhe me drejtorin;

Mbikëqyrje në evidencën e bibliotekës, bisedë me personin përgjegjës.

6. KUSHTET E PUNËS DHE SUKSESI

Notimi si pjesë e mësimit

- Politika e shkollës për notim
- Forma dhe metoda për notim
- Shfrytëzimi i informatave nga notimi në mësim

Shkolla i zbaton dispozitat pozitive ligjore që e rregullojnë notimin e nxënësve. Shkolla ka politikë të definuar për notim, qëllimi themelor i së cilës është ta mbështesë mësimin e secilit nxënës, duke përfshirë edhe kodin e notimit. Shkolla ka kritere të harmonizuara për notim, me të cilat nxënësit dhe prindërit janë tërësisht të informuar.

Të gjithë mësimdhënësit shfrytëzojnë metoda dhe instrumente të ndryshme për notim dhe në mënyrë të vazhdueshme e ndjekin dhe e notojnë zhvillimin e nxënësve. Nxënësit përfshihen në notim (përmes notimit personal, notimit midis veti, ndërtimit të kritereve, mbajtjes së dosjeve). Qasja në notim ju mundëson nxënësve të arrijnë rezultate më të mira.

Të gjithë mësimdhënësit u japin informata kthyesë nxënësve për punën e tyre, diskutojnë me nxënësit për arritjet dhe përparimin e tyre. Theks i veçantë i vihet vlerësimit të arritjeve aktuale të nxënësve dhe identifikimit të aktiviteteve të ardhshme që do të zbatohen në mësim. Mësimdhënësit i shfrytëzojnë tërësisht informatat e marra nga notimi që të përmirësojnë planifikimin dhe zbatimin e mësimit.

Shkolla i zbaton dispozitat pozitive ligjore që e rregullojnë notimin e nxënësve. Nxënësit dhe prindërit nuk janë të njoftuar me kriteret për notim. Një pjesë e madhe e mësimdhënësve shfrytëzojnë metoda dhe instrumente të ndryshme për notim dhe në mënyrë të vazhdueshme e ndjekin dhe notojnë përparimin e nxënësve. Notimi shumë u ndihmon nxënësve që të përmirësojnë rezultatet. Mësimdhënësit diskutojnë me nxënësit për arritjet dhe rezultatet e tyre dhe u japin rregullisht informata. Informata shpesh përmban detaje për arritjet dhe aktivitetet vijuese që duhet të ndërmerren. Mësimdhënësit i shfrytëzojnë informatat e marra nga notimi, në mënyrë që t'i përmirësojnë planifikimet dhe zbatimin e tyre në mësim.

Programi për punë i shkollës. Rregullore për notim dhe përparim të nxënësve. Rregullore interne për notim. Standarde për notim. Qasje në dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike. Mjete të shfrytëzuara për notim (teste të diturisë, lista për kontroll, lista me poena). Modele për punime të notuara të nxënësve.

6.1. Arritjet e nxënësve

Ndjekja e arritjeve të nxënësve me përkatësi të ndryshme gjinore, etnike (dhe gjuhës së mësimimit) në lëndet mësimore dhe sipas periudhës kualifikuese. Përmirësimi i arritjes së nxënësve me përkatësi të ndryshme gjinore dhe etnike (dhe gjuhës së mësimimit). Identifikimi i nxënësve që kanë vështirësi në mësim, të nxënësve me talent të veçantë dhe të nxënësve me nevoja të veçanta. Përmirësimi i arritjes së nxënësve përmes mësimimit të rregullt dhe plotësues. Ndjekja e arritjes së nxënësve gjatë kalimit prej një cikli në një tjetër dhe prej një niveli në një nivel tjetër arsimor. Shkolla disponon me të dhëna për arritjen e nxënësve sipas përkatësisë gjinore dhe etnike (dhe sipas gjuhës mësimore), në të gjitha lëndët mësimore dhe për të gjitha periudhat kualifikuese.

Shkolla krijon bindjen se arritjet e nxënësve mund të përmirësohen. Sipas pasqyrës në arritjet aktuale të nxënësve (të fituara përmes testeve interne dhe të jashtme), shkolla planifikon dhe ndërmerr aktivitete të ndryshme për përmirësimin e vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve të përkatësive të ndryshme gjinore dhe etnike (dhe sipas gjuhës mësimore). Shkolla ka sistem për identifikim të nxënësve që kanë vështirësi në mësim, të nxënësve me talent të veçantë, si dhe të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe vazhdimisht ndjek përparimin e tyre.

Në procesin e rregullt mësimor, shumica e mësimdhënësve mbështesin nxënësit që kanë vështirësi në mësim, nxënësit me nevoja të veçanta mësimore, si dhe nxënësit me talent të veçantë, duke zgjedhur aktivitete adekuate sipas nevojave dhe mundësive të tyre. Gjatë tërë vitit, shkolla realizon mësim plotësues nga të gjitha lëndët, për të cilat nxënësit kanë vështirësi dhe mësim plotësues për nxënësit të cilët tregojnë rezultate të mëdha në disa fusha. Shkolla, në mënyrë të vazhdueshme ndjek arritjen e nxënësve gjatë kalimit prej një cikli në një cikël tjetër dhe pas mbarimit të shkollës fillore dhe të mesme. Në qoftë se paraqiten ndryshime në arritjet e tyre gjatë kalimit prej një cikli në një cikël tjetër, shkolla i analizon shkaqet për një dukuri të këtillë dhe ndërmerr aktivitete për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Në bazë të pasqyrës së arritjes aktuale të nxënësve, shkolla planifikon dhe ndërmerr aktivitete të ndryshme, sipas përkatësisë gjinore dhe etnike (dhe sipas gjuhës mësimore). Shkolla i identifikon nxënësit e talentuar, nxënësit që kanë vështirësi në mësim, si dhe nxënësit me nevoja të veçanta mësimore dhe zhvillimin e tyre nuk e ndjek në mënyrë sistematike.

Një numër i vogël i mësimdhënësve në procesin e rregullt mësimor, mbështesin nxënësit që kanë vështirësi në mësim, nxënësit që kanë nevoja të veçanta mësimore, si dhe nxënësit e talentuar. Shkolla realizon mësim plotësues në fund të vitit shkollor për të gjithë nxënësit që kanë notat e dobta në disa lëndë. Mësim plotësues për nxënësit që tregojnë rezultate të veçanta në disa lëndë. Shkolla i ndjek arritjet e nxënësve gjatë kalimit prej një cikli në një cikël tjetër dhe ndërmerr aktivitete të veçanta për tejkalimin e ndryshimeve që paraqiten në këto situata.

6.2. Rezultatet e nxënësve

Kjo fushë shërben për vlerësimin e rezultateve të shkollës në bazë të rezultateve dhe kalueshmërisë së popullatës shkollore si e tërë.

Por, vlerësimi i nxënësve ka lidhje me tre probleme të rëndësishme:

- efektivitetin
- nivelin e rezultateve
- efienca

Për kalueshmërinë e nxënësve të veçantë shërben karakteristikë

- Efektiviteti

Ka të bëjë me njohuritë , dijet dhe shprehjet që kanë fituar nxënësit. Në këtë rast inspektimi i kushton vëmendje kryesisht kontributit që jep shkolla për arritjen e rezultateve, pra vlerës që ajo shton formimin e nxënësve.

Kjo është arsyeja për se merren parasysh karakteristikat e grupit të nxënësve.

Nivel i rezultateve

Është niveli që arrijnë nxënësit nga pikëpamja e përfundimit të shkollës. Këto rezultate duhen krahasuar me numrin e nxënësve që kanë përfunduar shkollën. Por niveli i rezultateve mund të përcaktohet edhe brenda një cikli nëpërmjet rezultateve që kanë arritur nxënësit në klasën ku janë, krahasuar me rezultatet në klasën e mëparshme.

Shpesh inspektimi krahason nivelin e rezultateve të një klase në momentin e inspektimit me ato të mëparshme.

Efiqenca

Ka lidhje me kohën që u duhet nxënësve të përfundojnë një nivel të caktuar shkollimi. Fjala është për nxënësit mbetës, nxënësit mbetës ulin efiqencën e shkollës politikën arsimore të pushtetit vendor, historikun e shkollës etj.

6.3. Menaxhimi dhe organizimi i kushteve dhe suksesi

Tabloja e vlerësimit krijon kushte për të caktuar se kur një shkollë është e mirë nga pikëpamja e fushës së menaxhimit dhe organizimit të saj. Kështu, një shkollë e mirë monitoron dhe rritë cilësinë e arsimit të nxënësve të saj.

Ajo analizon e vlerëson rregullisht rezultatet e nxënësve dhe mënyrën e saj të funksionimit. Mbi këtë bazë, shkolla ndërmer veprime për përmirësim të metejshëm të cilësisë së saj.

Organizimi i saj i punës është efiçiente dhe efektiv. Plani i punës për realizimin e programit mësimor dhe punën që zhvillohet në klasë është i qartë. Njerëzit punojnë në grupe dhe shkolla ku kanë krijuar mundësitë për kualifikimin profesional të secilit anëtar të stafit mësimor. Stafit dhe burimet materiale, financiare etj, përdoren me përgjegjësi.

Shkolla vendos lidhje të ngushta me ciklet paraardhëse dhe me kategoritë e shkollave ku shkojnë nxënësit e saj.

Gjendja bazë e shkollës

Çdo shkollë përballlet me faktorë të cilët nuk mund të ndryshohen brenda një kohe të shkurtër. Faktorët mund të jenë të lidhur me zonën ku gjendet shkolla ose me problemet brenda saj. Prandaj, problemi themelor është përcaktimi i faktorëve në gjendjen bazë të shkollës, të cilët influencojnë në mësimdhënie, të nxënësve dhe rezultatet e nxënësve të shkollës.

Karakteristikat e gjendjes bazë të shkollës nuk përbëjnë ndonjë fushë të vlerësimit të shkollës nga ana e inspektimit. Megjithatë, ato janë të rëndësishme për analizën e cilësisë së arsimit nga pikëpamja e kushteve të shkollës.

Gjatë inspektimit të plotë të shkollës trajtohen faktorët e mëposhtëm:

- **përbërja e popullatës shkollore**
- **përbërja e stafit**
- **gjendja fizike e shkollës**

Menaxhimi i klasës

Menaxhimi i klasës përbëhet kryesisht nga aspekti fizik dhe social i tij dhe është përgjegjësi e mësuesit dhe nxënësve për ta siguruar dhe për ta mbrojtur në mënyrë që ai të jetë sa më efektiv për zhvillimin me sukses të mësimit.

Disa aspekte kyçe të menaxhimit të klasës janë:

- **mësime të planifikuara mirë dhe interesante**
- **zhvillimi i nxënësve për të nxënë**
- **rregullat e klasës**
- **disiplina pozitive e klasës**

Menaxhimi i klasës nuk është gjë tjetër veçse zbatimi dhe përdorimi i të gjitha rregullave dhe procedurave për sigurimin e rregullit, disiplinës dhe mbarëvajtjes së mësimit në klasë. Që menaxhimi të jetë sa më i efektshëm duhet të zbatohen disa teknika të tij.

Këto teknika të menaxhimit të klasës fillojnë që në fillim të shkollës

- mësuesi tregon se është i përgatitur për një punë të gjatë që e pret përpara dhe se ka besim tek vetja për të realizuar që në ditën e parë të shkollës

- mësuesi i demonstroi në mënyrë të vazhdueshme se është kompetent, i përgatitur mirë dhe se është në krye të punës.

- mësuesi duhet të jetë profesionist i këndshëm dhe të përpiqet që të krijojë një atmosferë miqësore me nxënësit në klasë.

- mësimi duhet organizuar me variacione.

Menaxhimi i klasës ka lidhje të ngushtë me sjelljen e mësuesit. Për këtë mësuesi duhet të jetë i drejtë me nxënësit, të zotërojë mirë lëndën, të kontrollojë emocionet e tij, të ndihmojë nxënësit në rast nevojë, të ndjekë ecurinë e nxënësve gjatë kryerjes së detyrave. Nga përvoja e vëzhgimeve mund të themi se mësuesi, jo rrallë humb shumë kohë në orën e mësimit, humbje e cila ndodh jo vetëm si rrjedhojë abuzive, po mbi të gjitha nga aftësitë e kufizuara menaxhuese të klasës.

Mësuesi nuk mund të luajë më rolin e burimit të informacionit si dikur, por ai në mënyrë të pashmangshme është pozicionuar si udhëheqës dhe organizues i mësimit që udhëheq

nxënësin për të kërkuar e mbledhur informacionin në mënyrë të drejtuar apo të pavarur, duke e pajisur me metodologjinë e studimit dhe përpunimit të këtij informacioni.

Pikërisht në këto momente shfaqet aftësia e menaxhimit të klasës nga ana e mësuesit, aftësi e cila duhet të karakterizohet nga vëzhgimi i kujdesshëm, vlerësimi i sjelljeve në klasë, gatishmëria për t'iu përgjigjur në kohë sjelljeve të papërshtatshme, duke pritur drejt krijimit dhe ruajtjes së një klime pozitive dhe sa më të përshtatshme në procesin e mësimdhënies.

6.4. Motivimi i nxënësve

Mësuesit që vijnë në klasat joformale mësojnë dhe nxënë më mirë atëherë kur janë të motivuar. Kjo ndodh atëherë kur ata:

- janë të qartë për veprimtaritë që po kryejnë dhe qëllimin që ata kanë
- mund të punojnë vetë duke u mbështetur në njohuritë që ata vetë kanë
- marrin pjesë aktivisht gjatë zhvillimit të veprimtarive duke krijuar hapësirë që të përdorin gjuhën dhe perceptimet e tyre për të kuptuar.

Përvec kësaj nxënësit që marrin pjesë në këto klasa do të përfshiheshin me aktivisht në veprimtaritë e zhvilluara në qofte se ata:

- **kanë mjedise të përshtatshme dhe siguron mundësi të punojë së bashku me të tjerët dhe po ashtu e çliron nga presioni i notës apo i gabimit.**
- **kanë kohë të mendojnë dhe të reflektojnë rreth asaj që kanë mësuar.**
- **kanë një sërë mundësi zgjedhjesh për çfarë, kur dhe si duan të mësojnë.**

Qëllimi dhe arsyeja e këtij studimi është

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësohen hapat e parë të procesit të zhvillimit dhe të zbatimit të planprogrameve të reja në Kosovë dhe në veçanti, përputhjet ndërmjet planprogrameve, metodologjisë dhe vlerësimit në fusha të caktuara të planprogrameve të shkollës fillore. Fushat specifike të studimit dhe raportimit janë:

1. Mësimi i shkencave natyrore dhe shoqërore
2. Mësimdhënia
3. Arsimi profesional i nxënësve

7. Perceptimi i ndryshimeve nga prindërit, nxënësit, bashkësinë lokale dhe afariste

- Bashkëpunimi i shkollës me prindërit
- Bashkëpunim me bashkësinë lokale
- Bashkëpunimi me bashkësinë afariste dhe sektorin joqeveritar

Shkolla ndërmerr aktivitete të shumta të planifikuara mirë dhe organizon trajnime që t'i nxisë prindërit të inkuadrohen në punën edukative-arsimore të shkollës në të gjitha nivelet. Prindërit nxiten që të marrin pjesë aktive në procesin mësimor përmes organizimit të ligjëratave në një temë konkrete ose me vizita në vendin e punës të prindit, si dhe në aktivitete të lira.

Shkolla shfrytëzon metoda efektive për komunikim me prindërit, përmes organizimit të takimeve individuale prindore dhe ditëve të hapura për pritje, duke iu përshtatur kohës së lirë të prindërve. Informatat që kanë të bëjnë me të gjitha aspektet e punës të shkollës, siç janë qëllimet, organizimi, aktivitetet e ardhshme dhe niveli i arritjes së nxënësve janë të qarta, të organizuara mirë dhe janë të kapshme për prindërit. Prindërit janë të mirëpritur në shkollë.

Shkolla është inkuadruar në mënyrë aktive në jetën e bashkësisë lokale përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta dhe përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje me interes për bashkësinë. Shkolla promovon inkuadrimit vullnetar të nxënësve në aktivitetet e bashkësisë. Bashkësia angazhohet për përmirësimin e kushteve të punës në shkollë. Shkolla promovon dhe pranon ndihmën vullnetare të bashkësisë në aktivitetet mësimore dhe të lira.

Shkolla realizon punë cilësore me bashkësinë afariste, përmes mësimi praktik të organizuar mirë dhe përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta të inicuar nga të dyja palët. Ekzistojnë shumë shembuj konkret për bashkëpunim të suksesshëm me sektorin joqeveritar dhe pjesëmarrja aktive e të punësuarve në projekte me interes të bashkësisë.

Mjaftueshëm shkolla e pranon mbështetjen e prindërve, të cilët me iniciativën e vetë dëshirojnë të marrin pjesë në jetën dhe punën e shkollës, por nuk ndërmerr aktivitete që t'i përfshijë të gjithë prindërit. Ndërkaq, shkolla nxit prindërit të përfshihen në punën e shkollës vetëm në suazat e niveleve formale të vendimit (Këshillin e prindërve, mbledhjet prindore dhe Këshillit shkollor).

Komunikimi i shkollës me prindërit zbrit në mbajtjen e dy mbledhjeve prindore në një gjysmëvjetor, por ka raste kur mbahen mbledhje individuale prindore. Informatat që kanë të bëjnë me punën e shkollës janë të shkurtëra dhe të paqarta për prindërit.

Ka prindër, të cilët mendojnë se nuk janë të mirëpritur nga një pjesë e të punësuarve në shkollë.

- Shkolla realizon bashkëpunim me bashkësinë lokale vetëm në suazat e obligimeve ligjore formale dhe ka shumë pak raste kur bëjnë projekte dhe ngjarje të përbashkëta.

- Shkolla bashkëpunon me bashkësinë afariste për realizimin e mësimit praktik.

7.1. Nxënësit, mësuesit, prindërit dhe shoqëria

Njësia e bashkërendimit prindër-arsimtar.

Fëmijet e suksesshëm në shkollë janë të suksesshëm edhe në jetë. Që fëmijet të jenë të suksesshëm në shkollë ata kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje.

Objektivat për të ardhmen

Zhvillimi i shkathtësive që krijojnë pjesëmarrje të vazhdueshme të prindërve, arsimtarëve dhe nxënësve për çështje që kanë të bëjnë me arsimin, funksioni i strukturave që mundësojnë pjesëmarrje të të gjithë aktorëve në reformat arsimore të funksionojnë strukturat e arsimit të cilat mundësojnë zbatimin e reformave në sistemin edukativ-arsimor.

Krijimi i një mentaliteti të ri të komunitetit për nevojat që ka shkolla në kushtet aktuale për ndihmë dhe mbështetje.

Këshilli i prindërve të shkollës

Qëllimi:

Themeli i Këshillit të Prindërve të Shkollës është që në shkollë të përfaqësohen në mënyrë sa më demokratike interesat e nxënësve, prindërve dhe arsimtarëve, të punojnë së bashku për të përmirësuar cilësinë në arsim.

Ky këshill ndihmon në krijimin e shkollave më miqësore për fëmijet dhe me atraktive për mësuesit. Të arriturat si rezultat i punës objektivi kryesor i studimit:

Zbulimi i opinionit dhe qëndrimeve të prindërve dhe drejtuesve të shkollave lidhur me bashkëpunimin prindër-shkollë, si dhe shkollës së përfshirjes së prindërve në jetën e shkollës.

7.2. Refleksionet-opnionet të mësuesve, nxënësve, prindërve dhe drejtorëve

1. Opinonet e mësuesve

Në fillim më është dukur se metodat klasike janë të pazëvendësueshme, por shumë shpejt kuptova se të nxënësit ndërveprues, të gjitha ato teknika në mënyrën më të përsosur i ndërrojnë metodat klasike.

Gjatë orës të gjithë nxënësit janë aktiv, shumë të lirë dhe pjesëmarrës të barabartë në mësim.

Anët pozitive të këtyre metodave dhe të formave të të nxënësit janë të shumta;

Shembull:

Nxënësit shprehin dëshirë të madhe të punojnë në grupe, sepse janë të lirë të dëshirojnë dhe të shprehin idet e tyre, para se t'i vlerësojmë ne ata, ata e vlerësojnë njëri-tjetërin, prinderit shprehin kënaqësi dhe pajtim me këtë punë, me metoda të reja, por ora mësimore shpesh është e shkurtër prej 45 minuta.

Duke i zbatuar teknikat e reja të të nxënësit ndërveprues punën kryesore e bëjnë vetë nxënësit me anë të aktiviteteve, lojërave, punë me grupe dhe zotërojnë me shumë kënde.

Trajnimet e mësuesve duhet të jenë në vazhdimësi që të përfshihen të gjithë.

Reforma është hap shumë i madh për arsimin në Kosovë, pasi që dihet se në çfarë periudhe ka kaluar arsimit ynë.

Të harmonizohen tekstet shkollore me plan-programet dhe metodologjitë e reja të mësimit dhe mësimdhënies.

Tekstet e klasave të para të kenë më shumë ilustrime dhe të jenë tërheqëse për fëmijë.

Të krijohen kushte në shkolla për të zbatuar metodologjitë e reja.

Të bëhen trajnime permanente e në veçanti trajnime lëndore.

Të zvogelohet numri i madh i nxënësve nëpër klasa.

Të rishikohen tekstet mësimore.

Objektivat të jenë të arritshme.

Të përmirësohet infrastruktura dhe kushtet shkollore.

Metodologjitë e reja nuk gjejnë zbatueshmëri nga ana e mësuesve.

2. Opinionet e nxënësve

Për ne këto metoda janë mjaft interesante. Mësimi është mjaft i kuptueshëm, si për mua ashtu edhe për shokët e shoqet.

Puna në grupe është më e mirë, sepse më shumë mbahet mend dhe i ndihmohet atij që nuk di. Mendoj kështu është shumë mirë.

Punojmë me shokët dhe shoqet dhe çdo gjë shkon mirë. Shokët dhe shoqet më ndihmojnë kur unë nuk di diçka, por edhe unë i ndihmoj ata.

Të mbahen më shumë aktivitete në shkollë.

Të mbahen më shumë teste.

Disa mësimdhënës nuk i aplikojnë reformat.

Të ndërtohen raportet mësimdhënës-nxënës.

Të ngritet përgjegjësia e nxënësve.

Arsimtarët të përgatiten për mësimdhënie.

Të pajisen shkollat me kabinete.

Të krijohet siguri më e madhe për nxënës në shkolla.

Të sigurohen mjete mësimore.

Të sigurohet hapësirë e mjaftueshme shkollore.

Të ngriten përgjegjësitë e nxënësve në shkollë.

Të mbahen më shumë orë praktike.

Të krijohen kushte për lëndën e informatikës.

Të rregullohet ambienti shkollor.

Të respektohet orari mësimor nga mësimdhënësit.

3. Opinioni i prindërve

Po vërehet një ndryshim tek fëmijët tanë: Do të thotë shumë lehtë po e kuptojnë dhe janë më të kënaqur, sidomos me punën në grupe, po vërejmë një vullnet.

Jemi të kënaqur dhe dëshirojmë që edhe më tutje të punohet në këtë drejtim.

Ne si prindër kemi vënë re se metodat e reja të mësimin që zbatohen nga nxënësit e lëndëve të ndryshme, kanë sjellë një freski të re tek fëmijët tanë. Tani interesimi i fëmijëve është më i madh për të mësuar dhe punuar në mënyrë më të përkushtuar, prandaj dëshirojmë që këto teknika të mësimin të vazhdojnë edhe më tej.

4. Opinioni i drejtorit

Trajnimet të mos mbahen gjatë orarit mësimor

Të mbahen trajnime për udhëheqje arsimore (menaxhim të klasës).

Të jenë të gjithë mësuesit e trajnuar

Të vazhdohet me trajnime në metodikë-didaktikë

Pa u trajnuar të gjithë mësuesit nuk arrihen reformat.

Të mbahen trajnime të vazhdueshme.

KAPI TULLI II

PJESA EMPIRIKE

1.1.LËNDA E KËRKIMIT (Objekt studimi)

Studimi i rolit të menaxhimit dhe ndryshimit dhe kushtet e punës në shkollat fillore të Prizrenit është objekt i këtij hulumtimi. Objekti i këtij studimi i përshtatet qasjes në strategji kërkimore të metodës kauzale, variantë jo eksperimentale. Modeli që e praktikojmë në këtë studim, demonstroi shembull të natyrës analitike shkencore. Me parashikim se rregullat e natyrës analitike shkencore. Me parashikim se rregullat e globalizimit të shoqërisë janë në rrjedhë që t'i imponohen edhe vendit tonë, ne kemi bërë përpjekje maksimale që ky studim të iniciojë vënien e udhëheqjes së shkollave në themele akademike që do t'i shërbejë gjeneratave si preventive në ngritjen e një shoqërie të ardhme që nxënësit do ta praktikojnë.

Do të praktikohen instrumente, teknika, strategji dhe metoda analitike nga hulumtime të natyrës deskriptive, jo eksperimentale që praktikisht praktikohen në vende me përvojë shkencore të zhvilluara.

Objekti i këtij studimi fokusohet në menaxhuesit e shkollave fillore të Prizrenit dhe modernizimin e këtyre shkollave me kuptimin e koncepteve të reja si nevojë e domosdoshme për udhëheqje moderne nëpër shkolla për të mbijetuar në konkurrencë të mjedisit modern me ekonomi të tregut të punës ku vazhdimisht është e pranishme dinamika e konkurrencës.

Motiv për t'iu qasur këtij problemi është gjendja e udhëheqësive aktuale në shkollat fillore të Prizrenit. Menaxhuesit si faktor kyq ndikojnë në krijimin e klimës pozitive në shkolla, ku çdo njëri do ta ndjejë veten të dobishëm dhe pjesëmarrës në arritjet e qëllimeve të vizionit. Menaxhuesit me harmonizimin të të gjithëve në shkollë, me formimin e bashkësive të nxënësve me anë të ndërveprimit të ndërsjellë, ndikon në përmirësimin e situatës dhe në krijimin e klimës demokratike në shkollë.

Menaxhuesit me sjelljen e tyre ndikojnë në rikulturimin e personelit për përmirësimin e mësimdhënies. Nëse menaxhuesit nga mungesa e dijeve për udhëheqje dhe menaxhim modern, nga mungesa e kuptimit të harmonizimit me personelin e shkollës, nga mungesa e motivimit të individëve të personelit për ta ndjerë veten si pjesëmarrës në arritjen e qëllimeve

të vizionit, përdor stilin detyrues dhe përcaktues të ritmit gjatë udhëheqjes në shkollë, atëherë paraqitet keqësimi i klimës në shkollë. Menaxhuesit e emëruar nga simpatia partiake involvon politikën në shkollë dhe pastaj paraqet konflikte në kolektiv, prishen marrëdhëniet ndërnjerëzore në kolektiv, mosrespektimi në mes mësimitdhënësve dhe demotivimi për rikulturim të vazhdueshëm të tyre. Nëse menaxhuesit e shkollave nuk kanë autonomi dhe përkrahje nga bashkësia lokale nuk mund të jenë në transparent dhe objektiv në punën e tyre. Nëse menaxhuesit nuk kanë bashkëpunim me agjentët e ndryshimit, shkolla nuk evoluon. Nëse nuk kanë motivim për pranim, zbatim dhe institucionalizim të risisë në shkollë, paraqitet si pasojë e qëndrimit negativ ndaj ndryshimeve të menaxhuesve aktual në shkollat fillore në Kosovë, respektivisht në rajonin e Prizrenit.

Menaxhuesit nuk mund ta mësojnë integrimin e risive në shkollë nga mungesa e kuptimit të vlerës të përpjekjeve të reja të ndryshimit të ofruar nga mungesa e shkathtësive për organizim, profesionalizim nga përvoja e punës si menaxhues. Pra, involvimi i politikës partiake në shkolla ia humb vlerën e postit të menaxhuesve. Ky ishte edhe njëri ndër motivet kryesore që ndikoi në përcaktimin për trajtimin e një teme të tillë. Me ç'rast u praktikuan instrumente, teknika, strategji dhe metoda analitike nga arsenalin e hulumtimeve të natyrës përshkruese (deskriptive), joeksperimentale që përafërsisht praktikohen në vende me përvojë shkencore të zhvilluar. Hulumtimi pretendon të vë në praktikë arsenalin shkencor për ekzaminimin eksplisit dhe implicit të objektit të këtij studimi. Vështirimi në përmbajtje të konceptit mbi menaxhuesit modern si udhëheqës dhe menaxhues në shkolla e cila u sqarua në pjesën teorike të këtij studimi, ia shtojnë edhe vështirimin në evoluimin e menaxhimit të menaxhuesve aktual në shkolla.

Qëllimi i këtij studimi është që në disa zona të vendit të analizohet cilësia e arsimit në shkollat 9-vjeçare. Problemet që prekin atë në përgjithësi si dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në rezultatet dhe braktisjen shkollore në veçanti.

Qëllimi është që të ndihmohen me informacion dhe me sugjerime ente private dhe publike të cilat veprojnë në fushën e edukimit, se si mund të ndërhyjnë konkretisht për zgjidhjen e tyre në mënyrë të efektshme. Për të marrë në shqyrtim cilësinë e arsimit në përgjithësi dhe dukurinë e braktisjes shkollore në një gamë të gjerë dimensionesh, studimi u krye në qytetin e Prizrenit. Arsyeja se përse u përzgjodh ky qytet është: sepse qyteti i Prizrenit ka përqendrim të lartë të popullsisë, të shkollave dhe të institucioneve arsimore.

1.2. QËLLIMET E KËRKIMIT

Synimi i këtij hulumtimi është të vëzhgojë kushtet e punës në shkollat fillore në Kosovë, në rajonin e Prizrenit. Pra, ky është edhe qëllimi i hulumtimit që synon ta ekzaminojë se si është gjendja e kushteve të punës. Tradicionalisht etapa e zhvillimit të arsimit janë etapa parapërgatitore, operative dhe verifikuese. Nisur nga rrethanat e veçanta në të cilat zhvillohet puna mësimore bashkëkohore, mësimdhënia u adaptohet zhvillimeve teknologjike të reja.

Duke u nisur nga ajo që parashtruam me lartë mund të themi se etapat e procesit të të mësuarit paraqesin një aspekt të veçantë për zgjerimin e bazës metodologjike dhe rritjen e nivelit profesional të mësimdhënies.

Hulumtimi u realizua në 4 shkolla fillore të Prizrenit, ku si studim mendonim ta praktikonim në shkollën fillore; “Mustafa Bakia”, “Lekë Dukagjini”, “Emin Duraku”, “Abdyl Frashëri”, për të parë nga afër se me çfarë kushtesh përballen këto shkolla, si i menaxhojnë ndryshimet , si i kanë pranuar, të konstatohet se a ka hapësirë të mjaftueshme të gjelbëruara në shkolla ku mund të dalin nxënësit gjatë pushimit.

Qëllimet duhet të dalin nga nevoja dhe dinamika e ndryshimeve.

1.3.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Lënda e hulumtimit

Në shkollat tona një numër i madh i mësimitdhënësve janë trajnuar me programe të ndryshme të metodologjive të reja të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies, të cilat kanë patur për qëllim që mësimitdhënësi të mos jetë vetëm burim informacioni, por organizator dhe udhëheqës i mirë i procesit mësimit, ndërsa nxënësi të jetë i përgatitur për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin. Si objekt hulumtimi kemi marrë atë se si janë menaxhimet ndryshimet dhe kushtet e punës në shkollat fillore në Prizren, a janë të trajnuar mësimitdhënësit me metodologjitë bashkëkohore, si dhe sa kanë ndikuar trajnimet në procesin mësimit;

- në planprograme,
- tekste mësimore,
- në vlerësim si dhe
- nevojat trajnuese.

Nevoja e hulumtimit

Ky hulumtim është i domosdoshëm për arsye se në të ardhmën do të kemi identifikimin e problemeve dhe vlerësimin e nevojave të menaxhimit, ndryshimit dhe kushteve të punës në shkollat fillore të Prizrenit, që është synim final për të ditur se çfarë trajnimi dhe zhvillimi duhet të kenë mësimitdhënësit. Gjithashtu, gjatë punës është planifikuar të hulumtojmë se cilat ndryshime kanë patur ndikim pozitiv në ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies dhe mësimitnxënies, sa dhe si janë duke u aplikuar programet e menaxhimeve me qëllim që ndryshimet për mësimitdhënësit të vazhdojnë.

Caktimi i kufijve

Hulumtimi është fokusuar vetëm në aspektin specifik të problemit. Qëllimi i hulumtimit është menaxhimi, ndryshimet dhe kushtet e punës në shkollat fillore të Prizrenit. Rezultatet dhe zbatueshmëria e teknikave të reja të punës.

Supozimet

Rezultatet e këtij hulumtimi mund të jenë tregues të konsiderueshëm në opinion, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe nevojat që kërkohen në këtë proces. Nevoja për aftësim permanent është e madhe, prandaj ky hulumtim nxjerr në pah nevojat dhe prioritetet e domosdoshme të mësimitdhënësve për t'u trajnuar, në aspektin e menaxhimit sa më të mirë të ndryshimeve në shkollat fillore të Prizrenit.

1.4 QËLLIMI DHE DETYRAT E HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit

Ky hulumtim ka për qëllim informimin se si kanë ndikuar metodologjitë e reja të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies në procesin mësimor dhe përmes rezultateve të tij, t'i nxjerrim rekomandimet e drejtuesve të shkollave, mësimitdhënësve, nxënësve.

Detyrat e hulumtimit

Për të arritur qëllimin e hulumtimit kemi zgjedhur disa detyra;

- Të analizojmë dhe të studiojmë këtë problem;
- Të hartojmë anketën (pyetësin), si mjet hulumtimi;
- Të informojmë udhëheqësit e shkollave;
- Të grumbullojmë të dhëna përmes pyetësorëve;
- Të bisedojmë me palët e interesit;
- T'i përpunojmë të dhënat e grumbulluara;
- Të nxjerrim rekomandime;
- T'i interpretojmë rezultatet e hulumtimit.

Definimi i problemit

Gjatë implementimit të reformave në arsim janë paraqitur probleme të ndryshme. Këto probleme nuk janë asgjë tjetër vetëm synime për të arritur deri tek ajo se çfarë dëshirojmë.

Mirëpo, për të arritur deri te përmirësimi i gjendjes në arsim, kemi hasur në vështirësi të mëdha për përdorimin e metodologjive të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies nga mësimdhënësit dhe vështirësitë e nxënësve për t'u përballur me këto metoda. Ka mësimdhënës që janë kundër këtyre reformave, sepse ata nuk janë në gjendje të ndryshojnë dhe për këtë arsye edhe reforma është keqkuptuar.

Gjithashtu, kemi konstatuar se pengesat në këtë drejtim janë edhe teknike

mungesa e hapësirës shkollore dhe e mjeteve mësimore.

Nga kjo kemi konstatuar se të gjitha përparësitë dhe mangësitë janë të natyrave subjektive dhe objektive.

1.4.HIPOTEZA

Hipoteza kryesore e këtij hulumim është:

Në konceptin bashkëkohor të menaxhimit, ndryshimit të kushteve të punës në shkollat fillore dhe e klimës në shkollë.

Menaxhimi, ndryshimi dhe kushtet e punës në shkolla fillore, për ndryshimet në shkollë orienton drejt një bindjeje se roli dhe përgjegjësia e tyre ka tendenca të nënshtrimit të faktoreve EKSTERN.

Hipoteza ndihmëse: Mjedisi i brendshëm e pranon menaxhuesin moderator për shkak se ofron kushte të mira dhe ndërvepron me agjentët e ndryshimit për të mirën e inputit që gjendet në shkollë.

Hipoteza ndihmëse: Mjedisi i jashtëm përmes involvimit të politikës në institucionet shkollore ndikon negativisht në shkolla.

Ngritja e hipotezave

Kemi supozuar se menaxhimet, ndryshimet dhe kushtet e punës në shkollat fillore të Prizrenit për procesin mësimor ndikojnë pozitivisht në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Një numër i madh i mësimdhënësve nuk i zbatojnë këto teknika të reja në praktikë.

Mos zbatueshmëria e metodologjive të reja e kërkon nevojën urgjente të organizimit dhe përgatitjeve për monitorim të përhershëm të të gjitha strukturave në shkolla, nga njerëz kompetentë, në mënyrë që të përkrahet dhe përparohet puna në shkolla.

Mungesa e trajnimeve, keqkuptimi i reformës arsimore, pjesëmarrja e mësimitdhënësve në trajnime vetëm për t'u certifikuar, janë probleme që gjithashtu kanë lindur nevojën për këtë hulumtim.

1.5. VARIABLAT E STUDIMIT

VARIABLA e varur e këtij studimi: -drejtori modern

VARIABLA të pavarura të këtij studimi: - klima e shkollës

- rikulturimi i mësimitdhënësve
- përmirësimi i kulturës së prindërve
- përmirësimi i mësimitdhënësve
- përmirësimi i të arriturave të nxënësve
- përmirësimi i sjelljes së nxënësve
- ndikimet e jashtme

Studimi është ndarë në dy faza:

Faza e parë pati si objektiv vlerësimin e:

cilësisë së infrastrukturës,

trajnim-kualifikimit për mësuesit dhe drejtorët,

rezultateve në shkollë dhe braktisjen e saj nga nxënësit.

Faza e dytë pati si objektiv kryesor:

analizën e braktisjes së shkollës si e hapur dhe e fshehtë.

Në të dy fazat e studimit u morën parasysh faktorë të ndryshëm që mendohen se ndikojnë në shkallë e në forma të ndryshme në aspektet sasiore dhe cilësore të arsimit në përgjithësi dhe atij të nxënësit në veçanti të tillë, si: madhësia e familjes, të ardhurat, burimet e të ardhurave, aftësia e kufizuar, pjesëmarrja, perceptimi për të ardhmen e femijëve, shërbimet shkollore, përdorimi i shërbimeve, efikasiteti i shërbimeve, diskriminimi, keqtrajtimi, metodologjia e mësimitdhënies, efikasiteti i orarit, metodat motivuese, vlerësimi, pjesëmarrja, ndëshkimi, lloji i aktiviteteve të organizuara, puna në grup, pritshmëritë, formimi dhe praktikat e mësimitdhënies së mësuesve, etj.

1.7. INSTRUMENTET E KËRKIMIT

Në të dyja fazat e studimit janë përdorur instrumente të ndryshme, vlefshmëria e të cilëve sigurohet nga gjykimi i ekspertëve

Në fazën e parë mbledhja e të dhënave u krye përmes:

pyetësorit për mësuesit

pyetësorit për drejtuesit e shkollave 9-vjeçare

Pyetëtori i drejtuesit të shkollave përfshin 122 variabla të grupuara në 25 pyetje, të cilat në të shumtën e rasteve ishin të mbyllura. Pyetëtori i mësuesve mbledh të dhëna në 128 variabla të grupuara në 25 çështje, pjesa më e madhe e të cilave me përgjigje të detyruara. Për secilën shkollë u organizuan pesë fokus grupe të cilat kishin si qëllim testimin dhe plotësimin e të dhënave që dolën nga përpunimi i pyetësorëve.

Në fazën e dytë mbledhja e të dhënave u krye përmes:

vëzhgimit në klasë,

intervistës me mësuesit kujdestar,

fokus grupeve me nxënës,

fokus grupeve me ekspertë që punojnë në shkollat 9-vjeçare

pyetësorit me prindër.

Shkollat në studim. Studimi u kufizua në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Prizrenit. Në fazën e parë u përfshinë 5 shkolla.

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe interpretimet kërkohet:

Vlerësimi dhe monitorimi

Vlerësimi i situatës së cilësisë së arsimit si bazë për planifikim të ndërhyrjeve konkrete. Ndjekja me kujdes nga shteti e hapjes së institucioneve të arsimit sidomos ato private.

1.8. METODA E KËRKIMIT

